

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5408  
E premte, 23 shkurt 2018  
çmimi 0.40 €

## NATO-ja e do FSK-në ushtri, pas ndryshimeve kushtetuese ■ FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**TOMË GASHI PRET LIRIMIN E  
AKTIVISTËVE TË  
VETËVENDOSJES F. 6**

**UNIVERSITETI "ISA  
BOLETINI" PRANOHEM NË  
RRJETIN EVROPIAN PËR  
INTEGRIM AKADEMIK F. 10**

**SHBA-JA RINOVON NJË  
SHKOLLË NË VUSHTRRI F. 10**

### EKONOMI

**MINISTRI HAMZA KËRKON  
NGA MINISTRITË QË T'I  
IMPLEMENTOJNË PROJEKTET F. 9**

**BEQAJ: DO T'I MBËSHITESIM  
IDETË DHE NDËRMARRJET QË  
KANË VIZION TË QARTË F. 8**

### KULTURË

**HAPET 'EKSPOZITA BAZË' NË  
MUZEUN E KOSOVËS F. 13**

### SPORT

**KOSOVA, PËR BEFASI NDAJ  
POLONISË F. 18**

**PËRFUNDON AVENTURA E  
KOSOVËS NË  
'PYEONGCHANG 2018' F. 18**

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADEM GRABOVCI ■ FAQE 4-5



## Jepini fund izolimit, miratojeni demarkacionin

- Mbjajta pezull e demarkacionit dëmton  
raportet e Kosovës me ShBA-në,  
Bashkimin Evropian dhe NATO-n

Ish-shefi i grupit parlamentar i  
Partisë Demokratike të Kosovës  
(PDK), aktualisht anëtar kryesisë i  
kësaj partie, Adem Grabovci, u ka  
bërë thirrje deputetëve t'i japin  
fund izolimit të Kosovës, duke votu-  
ar në favor të marrëveshjes së

demarkacionit me Malin e Zi. Në  
këtë intervistë dhënë për gazetën  
"Epoka e re", Grabovci ka thënë se  
mbajta pezull e këtij procesi  
dëmton interesat e shtetit të  
Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Po  
ashtu, ai ka thënë se mosvotimi i

demarkacionit dëmton edhe  
raportet e Kosovës me ShBA-në,  
BE-në dhe NATO-n. Grabovci ka  
theksuar se deklarata e përbashkët e  
dy presidentëve lejon korrigjimin e  
demarkacionit nëse ka pasur  
lëshime

EDHE NJË SEANCË TJETËR ËSHTË THIRRUR PËR  
SOT (E PREMTE) PËR VOTIMIN E MARRËVESHJES  
SË DEMARKACIONIT ME MALIN E ZI

## Nuk ka konsensus për demarkacionin

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit  
të Kosovës, në të cilën ishte paraparë  
të votohet të enjten Projektligji për rat-  
ifikimin e marrëveshjes për shënjimin  
e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe

Malit të Zi, është shtyrë për sot në orën  
10:00. Presidenti i vendit, Hashim  
Thaçi dhe kryeparlamentari Kadri  
Veseli kanë shprehur optimizmin e  
tyre për arritjen e një konsensusi bren-

da partive politike lidhur me çështjen  
e demarkacionit me Malin e Zi. Edhe  
ambasadori amerikan Greg Delawie u  
ka bërë thirrje deputetëve ta votojnë  
këtë marrëveshje ■ FAQE 3



## Kosova shënon progres në luftën kundër korrupsionit

Republika e Kosovës ka shënuar progres  
në luftën kundër korrupsionit duke lënë  
pas Shqipërinë, Maqedoninë dhe  
Bosnjën. Sipas rezultateve të Indeksit të

Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017  
të Transparency International, nga 180  
vende, Kosova është radhitur në vendin e  
85-të me 39 pikë ■ FAQE 7

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GRUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Bushati refuzon konferencën në Bosnjë, shkak Kosova

**TIRANË, 22 SHKURT** - Shqipëria është shumë e vendosur për respektimin e shtetit të Kosovës dhe pjesëmarrjen e saj në të gjitha konferencat rajonale. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, ka refuzuar ftesën për të marrë pjesë në Konferencën e Ministrave të

Jashtëm të Ballkanit Perëndimor. Ministri Bushati e ka informuar me një letër homologun e tij boshnjak Igor Crnadak, në të cilën shpreh keqardhjen e tij për mosrespektimin e formatit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ftesën e munguar për Kosovën, duke bërë

me dije në këto kushte mospjesëmarrjen e tij në këtë takim. Në argumentimin e vet, ministri Bushati i ka komunikuar ministrit Crnadak se nuk mund të ketë diskutim kuptimplot dhe të dobishëm mbi rrugën e Ballkanit Perëndimor drejt BE-së pa qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e

Ballkanit Perëndimor, në frymën e mirëkuptimit, respektit dhe gjithëpërfshirjes. Tematika e konferencës ishte "Ballkani Perëndimor dhe anëtarësimi në BE: bashkëpunim më i fuqishëm rajonal për një proces më të shpejtë të integritimit evropian", organizuar me iniciativë të



Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bosnjë e Hercegovinës, parashikuar për t'u mbajtur më 23 shkurt në Banja Lukë.

# Sulm në Ambasadën Amerikane në Podgoricë

Veterani i Ushtrisë jugosllave, i lindur në Krlevë të Serbisë, që punonte në mbrojtjen kundërajrore gjatë bombardimeve të NATO-s të vitit 1999, fillimisht hodhi një granatë dore në kompleksin e Ambasadës Amerikane në Podgoricë, pastaj bëri vetëvrasje

**Podgoricë, 22 shkurt** - Policia e Malit të Zi tha të enjten se një veteran i Ushtrisë jugosllave, i lindur në Krlevë të Serbisë, që punonte në mbrojtjen kundërajrore gjatë bombardimeve të NATO-s të vitit 1999, fillimisht hodhi një granatë dore në kompleksin e Ambasadës Amerikane në Podgoricë rreth mesnatës, pastaj bëri vetëvrasje.

Ambasada në faqen e saj në "Facebook" tha se asnjë nga personeli i saj nuk u dëmtua nga incidenti dhe, po ashtu, nuk pati njoftime për dëme materiale.

Malazias i moshës 41-vjeçare dhe i lindur në Serbi, u identifikua nga policia me inicialet D. J., por mediet thanë se emri i tij i plotë ishte Dalibor Jauković. Pak para mesnatës ai hodhi një granatë dore mbi gardhin e kompleksit të ambasadës, më pas hodhi veten në erë, u tha gazetarëve shefi i policisë, Enis Baković. Ai bëri me dije se po zhvillohen hetime për të përcaktuar nëse ai kishte vepruar i vetëm apo me të tjerët. "Ne po

kërkojmë në mediet sociale së bashku me FBI-në", tha ai. "Nuk ka shenja se ishte akt terrorist", tha prokurorja Lepa Medenica.

Policë me armë automatike dhe automjete patrullonin rrugët pranë ndërtesës së ambasadës të enjten në mëngjes pas incidentit. Megjithatë ambasada tha se stafi i saj ishte i padëmtuar, ambasada u mbyll për lëshimin e vizave deri në një njoftim tjetër. "Ambasada e ShBA-së në Podgoricë këshillon shtetasit amerikanë se në ambasadë ka një situatë aktive të sigurisë", thuhej në faqen e saj të internetit.

Ambasada, po ashtu, i udhëzoi amerikanët t'i shmangin tubimet e mëdha në Podgoricë dhe t'i monitorojnë mediat lokale për përditësime mbi situatën. Ajo i anuloi të gjitha shërbimet e parapara për ditën e enjte.

Qeveria e Malit të Zi tha se e dënon fuqishëm sulmin, ndërsa ministri i Brendshëm malazias, Mevludin Nuhoxhiq, dhe drejtori i Policisë, Sllavko



Stojanović, vizituan vendin e ngjarjes dhe Ambasadën Amerikane. Zëdhënësja e Bashkimit

Evropian, Maja Kocijančiq, tha se dhuna nuk është diçka që mund të falet, porse BE-ja pret rezultatet e hetimeve që po bëjnë

autoritetet malazias. Mali i Zi, nga një vend i vogël me dalje në det, u bë anëtar i 29 i NATO-s në muajin maj të vitit 2017.

## Blindohet Ambasada e ShBA-së në Tiranë

**TIRANË, 22 SHKURT** - Pas sulmit mbi Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Mal të Zi është vënë re një shtim i masave të sigurisë edhe në Ambasadën Amerikane në Tiranë. Përreth kësaj ambassade është vënë re një numër i shtu-

ar i efektivëve të policisë që bëjnë shërbim 24 orë nga mëngjesi i së enjtes. Sipas policisë, ky është një protokoll që zbatohet gjithmonë në rastet kur ndodh një sulm në rajon. Por, numri i efektivëve dallohet qartë nga një monitorim pranë

selisë së Ambasadës Amerikane në rrugën e Elbasanit, ku qëndrojnë në gatishmëri. Ndërkohë, burime nga policia thanë se po vlerësohet çdo informacion. Nën vëzhgim po mbahen edhe ambasadat e tjera në vend.

## Hahn: Do ta rekomandojmë hapjen e negociatave për Shqipërinë

**BRUKSEL, 22 SHKURT** - Komisionari i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn, ka dhënë një intervistë së fundmi për "Die Welt" mbi perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE. Hahn është shprehur se KE-ja do ta rekomandojë hap-

jen e negociatave të pranimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë deri në verë. "Komisioni Evropian ka shumë të ngjarë ta rekomandojë hapjen e negociatave deri në verë për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ne besojmë se të dyja vendet kanë bërë reforma

të rëndësishme dhe janë gati për këtë hap", është shprehur Hahn. Ndër të tjera, ai është shprehur se njerëzit në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor meritojnë një perspektivë evropiane. "Shqipëria ka bërë shumë në luftën kundër krimit të organizuar. Njerëzit merito-

jnë një të ardhme evropiane", theksoi Hahn. Rekomandimi i Komisionit të BE-së është një parakusht i domosdoshëm për një vendim të shteteve anëtare për t'i hapur negociatat e pranimit. Shqipëria ka qenë kandidatë për anëtarësim që prej vitit 2014.



Edhe një seancë tjetër është thirrur për sot (e premte) për votimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi

# Nuk ka konsensus për demarkacionin

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, në të cilën ishte paraparë të votohet të enjten Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, është shtyrë për sot në orën 10:00. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryeparlamentari Kadri Veseli kanë shprehur optimizmin e tyre për arritjen e një konsensusi brenda partive politike lidhur me çështjen e demarkacionit me Malin e Zi. Edhe ambasadori amerikan Greg Delawie u ka bërë thirrje deputetëve ta votojnë këtë marrëveshje

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Kuvendi i Kosovës e ka shtyrë për sot (e premte) seancën e jashtëzakonshme, ku në rend dite është votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Deri te shtyrja e seancës të enjten erdhi pasi nuk u sigurua numri prej 80 votave të nevojshme për ratifikimin e marrëveshjes. Andaj, liderët politikë dhe deputetët fituan edhe një ditë shtesë për negociata mes vete. Pas një pritjeje prej më gjatë se dy orë e gjysmë, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, doli në foltoren e Kuvendit i ftoi deputetët të shpërndahen. Ai ka thënë se seanca pritet të fillojë të premten nga ora 10:00. Veseli, pas shtyrjes së seancës, ka treguar para gazetarëve se kanë pasur një takim të suksesshëm me partitë politike, ambasadorin amerikan Greg Delawie dhe shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, Nataliya Apostolova. Sipas tij, në këtë takim kishte

frymë pozitive që deri në javën e ardhshme (të mërkurën) të përmbillet ratifikimi i marrëveshjes me Malin e Zi për shënjimin e vijës kufitare. "E gjithë përpjekja ime është arritja e një konsensusi nacional. Pra, të jemi unikë në seancë dhe të mos i maltretojmë më qytetarët. Nuk ka patriotizëm më të madh sot në Kosovë sesa hapja e perspektivës euroatlantike dhe liberalizmi i vizave për qytetarët", ka thënë Veseli.

Qeveria e Kosovës ia ka bashkangjitur këtij Projektligji edhe një raport të Komisionit shtetëror për shënjimin e vijës kufitare, i cili nuk e mbështet marrëveshjen e arritur me Malin e Zi më 2015, si dhe deklaratën e nënshkruar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Malit të Zi, Filip Vujanović, përmes së cilës shprehet gatishmëria dypalëshe për korrigjimin e gabimeve eventuale gjatë procesit të demarkacionit të kufirit. Për ratifikimin të kësaj marrëveshjeje, nevojiten 80 vota të deputetëve apo dy të tretat e

numrit të tërësishëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Aktualisht votën kundër e ka paralajmëruar vetëm Lëvizja Vetëvendosje, përderisa subjekti tjetër opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës, pritet ta kërkojë shmangien e votimit për raportin e komisionit shtetëror, të cilin e konsideron vetëm si një draft të papërfunduar.

Para fillimit të seancës, deputetja Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se kanë dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës padi ndaj presidentit Hashim Thaçi. Vetëvendosje e ka akuzuar Thaçin për "shkelje të rëndë" dhe "tradhti ndaj vendit" në çështjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Ajo iu referua nenit 124 të Kodit Penal të Kosovës, i cili e vë presidentin në përgjegjësi në rast të shkeljes së sovranitetit të shtetit. "Kemi deponuar në Prokurorinë Speciale kallëzimin

penal kundër Hashim Thaçit për shkak të veprës penale 'tradhti ndaj vendit'", ka thënë Haxhiu. Vetëvendosje i kishte marrë në seancë dosjet me emrat e atyre që kanë nënshkruar peticionin kundër demarkacionit. Edhe Lista Serbe ka bërë me dije se nuk do ta përkrahë ratifikimin e demarkacionit. "Një gjë e tillë nuk është dakorduar me ne dhe nuk do ta mbështesim demarkacionin", është theksuar në deklaratën e Listës Serbe, duke iu referuar disa shkrimeve nëpër media të ndryshme. "Ne do të vazhdojmë të luftojmë për të drejtat e bashkësisë serbe që jeton në Kosovë", është thënë në deklaratën e Listës Serbe.

Ndërkaq presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka ftuar të gjithë deputetët ta ratifikojnë demarkacionin, duke i bërë thirrje të veçantë edhe Listës Serbe. "Sot, kur krejt bota është duke na shikuar, besoj thellë në vullnetin e të gjitha partive politike për ta

ratifikuar këtë marrëveshje, e cila krijon një dinamikë të re edhe në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Vota për ratifikimin e demarkacionit është votë për lirinë e lëvizjes së qytetarëve në Zonën Shengen, është votë për Kosovën në Evropë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ambasadori Greg Delawie përmes një deklaratë për medie u ka bërë thirrje deputetëve ta votojnë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi. "Jam këtu që t'i inkurajoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës për ta ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi", ka deklaruar Delawie, i cili ishte i pranishëm të enjten në Kuvendin e Kosovës. Ai ka pohuar se kjo është një marrëveshje e denjë dhe e saktë. Delawie ka thënë se secili deputet duhet ta dijë qëllimin e fundit të saj, që është marrja e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. "Abstenimi është votë kundër, kështu që i ftoj të gjithë deputetët të votojnë për marrëveshjen", ka deklaruar ambasadori Delawie.

Marrëveshja për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë. Si e tillë, kjo marrëveshje ishte ratifikuar nga Kuvendi i Malit të Zi, por jo edhe nga ai i Kosovës. Pa ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se Kosova nuk mund të përfshihet në agjendën për liberalizimin e vizave.

## Fajon: Po ndjekim me interesim të madh debatin për demarkacionin

Edhe raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, përmes rrjeteve sociale ka thënë se po i ndjek me interesim të madh zhvillimet në Kosovë për çështjen e demarkacionit. "Po e ndjek me interesim të madh debatin dhe votimin për demarkacionin në Kuvendin e Kosovës. Gjithë të mirat për miqtë, partnerët e qytetarët që treguan përkushtim të vërtetë për liberalizimin e vizave. Mirënjohëse edhe për Malin e Zi", ka shkruar Fajon.



Flet për "Epokën e re", Adem Grabovci

# Jepini fund izolimit, mi

**- Mbjajtja pezull e demarkacionit dëmton raportet e Kosovës me ShBA-në, Bashkimin Evropian dhe NATO-n**



Ish-shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), aktualisht anëtar kryesisë i kësaj partie, Adem Grabovci, u ka bërë thirrje deputetëve t'i japin fund izolimit të Kosovës, duke votuar në favor të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Grabovci ka thënë se mbajtja pezull e këtij procesi dëmton interesat e shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Po ashtu, ai ka thënë se mosvotimi i demarkacionit dëmton edhe raportet e Kosovës me ShBA-në, BE-në dhe NATO-n. Grabovci ka theksuar se deklarata e përbashkët e dy presidentëve lejon korrigjimin e demarkacionit nëse ka pasur lëshime eventuale

Grabovci. Ish-shefi i grupit parlamentar i PDK-së ka pohuar se sikur të ishte deputet do ta votonte demarkacionin me Malin e Zi. "Pas nënshkrimit të deklaratës së përbashkët në mes të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Malit të Zi, Filip Vujanović, është hequr çdo dilmë sa i përket këtij procesi, pasi një dakordim i tillë lejon mundësinë që nëse ka pasur lëshime eventuale, të korrigjohet demarkacioni. Mbjajtja pezull e këtij procesi dëmton rëndë interesat e shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Po ashtu, mbajtja pezull e këtij procesi dëmton edhe raportet tona me miqtë ndërkombëtarë, ShBA-në, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Dua të besoj se deputetët e Kuvendit, pa dallime partiake do të veprojnë në favor të interesit shtetëror, duke votuar për demarkacionin, i cili do t'i jepte fund izolimit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj", ka thënë Grabovci.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, të enjten, në mungesë të konsensusit, ka dështuar mbajtja e seancës së jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Kjo seancë është paraparë të mbahet të premten. Si e vlerësoni këtë proces dhe si do të duhej të sillen deputetët e Kuvendit në raport me këtë marrëveshje?

**Grabovci:** Procesi i ratifikimit të demarkacionit është stërzgatur mjaft. Unë i kuptoj deputetët se në të kaluarën mund të kenë pasur dilema rreth kësaj teme. Edhe unë kam

pasur. Por, pas nënshkrimit të deklaratës së përbashkët në mes të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Malit të Zi, Filip Vujanović, është hequr çdo dilmë sa i përket këtij procesi, pasi një dakordim i tillë lejon mundësinë që nëse ka pasur lëshime eventuale, të korrigjohet demarkacioni. Mbjajtja pezull e këtij procesi dëmton rëndë interesat e shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Po ashtu, mbajtja pezull e këtij procesi dëmton edhe raportet tona me miqtë ndërkombëtarë, ShBA-në, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Dua të besoj se deputetët e Kuvendit, pa dallime partiake, do të veprojnë në favor të interesit shtetëror, duke votuar për demarkacionin, i cili do t'i jepte fund izolimit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Miratimi i demarkacionit nuk është vetëm interes i një grupi politik, por interes i çdo qytetari pa dallim bindje politike apo etnike. Në këtë drejtim duhet të jemi unikë sikurse kemi qenë në të kaluarën. Prandaj është koha e fundit që Kosova ta kalojë demarkacionin duke i hapur

**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Adem Grabovci, u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit ta votojnë marrëveshjen për ratifikimin e demarkacionit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Grabovci ka thënë se me votimin e kësaj marrëveshje do t'i jepej fund izolimit të qytetarëve të

Kosovës. "Miratimi i demarkacionit nuk është vetëm interes i një grupimi politik, por interes i çdo qytetari pa dallim bindje politike apo etnike. Në këtë drejtim duhet të jemi unikë. Prandaj është koha e fundit që Kosova ta kalojë demarkacionin, duke i hapur rrugë liberalizimit të vizave dhe proceseve të tjera integruese", ka thënë Grabovci.

Ai ka thënë se mbajtja pezull e këtij procesi dëmton interesat e qytetarëve të Kosovës dhe të vendit në raport me miqtë

ndërkombëtarë. "Mbjajtja pezull e këtij procesi dëmton rëndë interesat e shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Po ashtu, mbajtja pezull e këtij procesi dëmton edhe raportet tona me miqtë ndërkombëtarë, ShBA-në, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Dua të besoj se deputetët e Kuvendit pa dallime partiake do të veprojnë në favor të interesit shtetëror, duke votuar pro demarkacionit, i cili do t'i jepte fund izolimit të Kosovës dhe qytetarëve të saj", ka thënë

# ratojeni demarkacionin

rugë liberalizimit të vizave dhe proceseve të tjera integruese e zhvillimore.

**"Epoka e re":** Nga kjo marrëveshje, a humbet Kosova territor?

**Grabovci:** Askush nuk është i interesuar t'i falet tokë diku. Deklaratat se po i falet tokë Malit të Zi janë absurde dhe të pamatura. Në këtë drejtim nuk është mirë të luhet me ndjenjat e qytetarëve. Me ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit, pjesë e së cilës është edhe deklarata e dy presidentëve, i hapet rrugë rishikimit të pikave kufitare kontestuese me Malin e Zi. Prandaj nuk është mirë dhe nuk duhet të shpiken tema të ndryshme. Gjërat duhet t'i themi ashtu siç janë.

**"Epoka e re":** Po të ishit deputet, do ta votonit këtë marrëveshje?

**Grabovci:** Sa isha deputet kam pasur dilema rreth kësaj teme. Thashë dhe më parë se pas nënshkrimit të deklaratës në mes të dy presidentëve, do ta votoja këtë marrëveshje, sepse mundësohet rrishtimi i pikave kontestuese të kufirit me Malin e Zi. Prandaj, dua të them se çdo herë kam vepruar në interes të kombit, të shtetit dhe

në interes të qytetarëve të vendit tim. Edhe këtë herë do të vepra në interes të qytetarëve, shtetit dhe në interes të zhvillimit të gjithëmbarshtëm. Votimi i demarkacionit është akt patriotik dhe në interes të shtetit të Kosovës dhe hapjes së mundësive të reja.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, si jeni duke e parë punën e koalicionit qeverisës, pjesë e të cilit është edhe PDK-ja?

**Grabovci:** Personalisht kam pritur më shumë nga ky koalicion. Kam pritur të ketë veprime më të shpejta me kalimin e temave të mëdha, siç janë demarkacioni dhe ushtria. Po ashtu, kam pritur se do të ketë cilësi më të lartë qeverisëse. Ky koalicion ka kapacitete për të bërë më shumë dhe duhet të bëjë. Dua të besoj se pas kalimit të demarkacionit, ky koalicion do të fokusohet me shumë në tema të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të vendit.

**"Epoka e re":** Opozita është duke i kritikuar në vazhdimësi veprimet e Qeverisë Haradinaj, madje është duke e quajtur Qeveri të varur nga Beogradi.

**Grabovci:** Opozita ka të drejtë të kritikojë. Kjo është detyra e saj.

Opozita e tanishme është e zhurmshme, por e paalternativë. Ju e dini se PDK-ja gjatë kohës sa ka qenë në opozitë ka qenë mjaft konstruktive, sidomos në temat nacionale. Në këtë aspekt opozita e tanishme është dekonstruktive. Opozita nëse e do aq shumë Kosovën, atëherë duhet ta përkrahë Qeverinë në tema nacionale, siç janë demarkacioni, ushtria, integrimet evropiane etj.

**"Epoka e re":** Z. Grabovci, në fund të vitit të kaluar kishte një iniciativë për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, por më vonë pati një tërheqje nga kjo iniciativë. Cili është qëndrimi juaj për këtë gjykatë?

**Grabovci:** Historiku i Gjykatës Speciale është i gjatë. Ju e dini se fillimisht Raporti i Dick Martit nuk është marrë seriozisht nga ana e institucioneve të vendit. Ne nuk kemi arritur ta kundërshtojmë qysh në fillim këtë raport, i cili, për mendimin tim, ka qenë dhe mbetet kryekëput politik dhe i ndikuar nga Serbia dhe Rusia. Ky raport, edhe pse skandaloz dhe me përplot të pavërteta, është miratuar në Këshillin e Evropës. Pas miratimit të këtij raporti ne kemi qenë para aktit të kryer, ku është dashur të veprojmë. E

kam thënë vazhdimisht se Gjykata Speciale është një padrejtësi historike ndaj popullit të Kosovës dhe UÇK-së por, për hir të proceseve, e kemi përkrahur. Iniciativa për zhbërjen e kësaj gjykate ka qenë e pamenduar mirë dhe e vonshme. Ju i keni parë reagimet edhe të miqve ndërkombëtarë. Tani ajo çfarë duhet të bëjmë ne është ta mbrojmë në mënyrë dinjitoze luftën e UÇK-së. Kemi argumente të mjaftueshme për ta bindur këtë gjykatë se pretendimet e dala nga Raporti i Dick Matit janë të pabaza, absurde, të ndikuara dhe politike. Nuk ka gjykatë në botë që mund ta gjykojë luftën e drejtë të UÇK-së, e cila ka qenë çlirimtare dhe mbrojtëse.

**"Epoka e re":** Me çfarë jeni duke u marrë kohët e fundit?

**Grabovci:** PDK-ja është në proces të brendshëm zgjedhor. Në këtë kontekst jam duke u takuar me struktura të kësaj partie dhe me njerëz të ri të cilët kanë shprehur vullnetin t'i bashkohen vizionit të PDK-së. Pra, fokusi im është në mobilizimin dhe fuqizimin e PDK-së, e cila do të vazhdojë të jetë prijatë dhe proceseve të ardhshme, të cilat janë në interes të shtetit dhe të qytetarëve.

## NATO-ja e do FSK-në ushtri, pas ndryshimeve kushtetuese

PRISHTINË, 22 SHKURT - Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Ushtri të Kosovës duhet të bëhet në pajtim me reformat kushtetuese, ka thënë komandanti i Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli, James Foggo. Sipas tij, të gjithë liderët e Kosovës janë në dijeni se pa ndryshime kushtetuese FSK-ja nuk mund të shndërrohet në ushtri. "Aleanca e NATO-s dhe Këshilli i Atlantikut Verior ishin këtu para disa muajsh dhe ata e bënë shumë të qartë se për NATO-n, nëse bëhet transformimi i FSK-së në Ushtri të Kosovës, duhet të bëhet pas ndryshimeve kushtetuese", ka thënë Foggo në një konferencë për medie në selinë qendrore të KFOR-it në Prishtinë.

Komandanti Foggo ka folur edhe për kërcënimet e mundshme që mund të vijnë nga Serbia dhe ndikimi i Rusisë në Ballkan, në veçanti në Kosovë. Pavarësisht

prej raporteve të mira midis Serbisë dhe Rusisë, Foggo ka thënë se nuk ka vend për shqetësim. "Ka pasur shtitje të armëve, të avionëve. Disa avionë që i janë shitur Serbisë unë nuk do t'i blija. Janë MIG 29. Janë të vjetër dhe nuk paraqesin kërcënim", ka thënë Foggo.

Krijimi i Ushtrisë së Kosovës përmes ndryshimeve kushtetuese në vazhdimësi është kundërshtuar nga Lista Serbe, e cila përkrahet nga Beogradi. Pa votat edhe të Listës Serbe nuk mund të ketë ndryshime kushtetues. Pas pengesave të shumta, vitin e kaluar, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kishte tentuar që transformimin e FSK-së ta bënte përmes një projektligji i cili do ta mundësonte shndërrimin e FSK-së në një forcë me kompetenca mbrojtëse, ushtarake. Iniciativa e Thaçit ishte kundërshtuar nga NATO-ja, Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja. (REL)



# Tahiri: Kosova, i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që kompenson viktimat e krimit

**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të enjten në takim anëtarët e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në shënim të Ditës Evropiane të Viktimave të Krimit. Duke qenë i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që ka Ligj për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ministri Tahiri ka shprehur përkushtimin e tij për t'i ndihmuar qytetarët që janë viktimat e krimit për realizimin e të drejtës ligjore për kompensim. "Konsideroj se drejtësia nuk mund të arrihet nëse viktimat harrohen apo nuk

trajtohen në mënyrë të drejtë, për këtë qëllim sistemi ynë i drejtësisë po transformohet çdo ditë duke vënë në qendër mbrojtjen e viktimës" ka thënë Tahiri. Ministri Tahiri ka falënderuar anëtarët e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit për punën që e kanë bërë, duke i siguruar se baza ligjore e këtij programi siguron qëndrueshmëri financiare dhe institucionale, duke marrë parasysh se fondi për kompensim të viktimave vjen nga të hyrat e taksave gjyqësore dhe prokuroriale dhe për vitin 2018 janë ndarë 87 mijë euro që shfrytëzohen ekskluzivisht për kompensim të viktimave. "Ne asnjëherë nuk mund ta kompensojmë vuajtjen



e viktimave, por duhet të vazhdojmë t'i ndërmarrim të gjitha masat për t'i minimizuar vuajtjet e tyre që kanë përjetuar gjatë dhe

pas krimit" ka thënë Tahiri. Ndërsa Nesrin Lushta, kryesuese, ka bërë me dije se Komisioni është funksional nga prilli i vitit të

kaluar dhe se qëllim kryesor të punës së tyre kanë që viktimat të trajtohen pa diskriminim, me respekt dhe dinjitet.

## Tomë Gashi pret lirim të aktivistëve të Vetëvendosjes



**PRISHTINË, 22 SHKURT (ER)** - Avokati i deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Frashër Krasniqi, Tomë Gashi, ka bërë me dije se Gjykata e Apelit në Prishtinë ka përfunduar të enjten seancën në të cilën ka shqyrtuar ankesën e tij për katër aktivistët e kësaj lëvizje, të cilët dyshohen për sulmin mbi objektin e Kuvendit të Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook", avokati Gashi ka shkruar se aktvendimi i vetëm i drejtë në këtë rast është vërtetimi i pafajësisë për të gjithë aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje. "Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë sot ka mbajtur seancën e kolegjit, në të

cilën ka shqyrtuar ankesat e avokatëve në rastin e dënimit të padrejtë të aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Atthe Arifi dhe Egzon Haliti. Kolegji i Gjykatës së Apelit sa më shpejt që të jetë e mundur do të nxjerrë vendim lidhur me ankesat tona. Ne besojmë se aktvendimi i vetëm i drejtë mund të jetë, vërtetimi i pafajësisë i të gjithë aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Unë besoj në këtë panel të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë se, po ashtu, do ta ndërpresë paraburgimin e padrejtë ndaj këtyre aktivistëve", ka shkruar Gashi.

## Mbahet takimi i Asamblesë së Kryetarëve dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës të Gjykatave

**PRISHTINË, 22 SHKURT (ER)** - Të enjten është mbajtur takimi i parë i Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës nën udhëheqjen e kryesuesit Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj. Gjatë këtij takimi janë diskutuar një mori sfidash të cilat e përcjellin sistemin gjyqësor në Kosovë, duke filluar nga pika e parë e rendit të ditës, ku është diskutuar për përfshirjen aktive të gjyqësorit në procesin e draftimit të ligjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin. Lidhur me këtë çështje, Asambleja i rekomandon Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) të nënshkruajë një marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim që për hartimin fillestar të draftligjeve të marrin pjesë ekspertët e fushave përkatëse të sistemit gjyqësor. Edhe Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative të KGJK-së, të nevojshme për vitin 2018, zënë vend të rëndësishëm në këtë takim, ku u diskutua nga të gjithë të pranishmit, të cilët njëzëri u pajtuan që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të hartojë një strategji për miratimin e rregulloreve brenda vitit, duke filluar këtu nga rregullorja për përcaktimin e normave për gjyqtarë dhe gjyqtarë mbikëqyrës, hartimi i rregullores të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme, hartimi i rregullores për arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve të vjetra dhe të tjera.

lim që për hartimin fillestar të draftligjeve të marrin pjesë ekspertët e fushave përkatëse të sistemit gjyqësor. Edhe Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative të KGJK-së, të nevojshme për vitin 2018, zënë vend të rëndësishëm në këtë takim, ku u diskutua nga të gjithë të pranishmit, të cilët njëzëri u pajtuan që Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të hartojë një strategji për miratimin e rregulloreve brenda vitit, duke filluar këtu nga rregullorja për përcaktimin e normave për gjyqtarë dhe gjyqtarë mbikëqyrës, hartimi i rregullores të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme, hartimi i rregullores për arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve të vjetra dhe të tjera.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017 të Transparency International

# Kosova shënon progres në luftën kundër korrupsionit

Republika e Kosovës ka shënuar progres në luftën kundër korrupsionit duke lënë pas Shqipërinë, Maqedoninë dhe Bosnjën. Sipas rezultateve të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017 të Transparency International nga 180 vende, Kosova është radhitur në vendin e 85 me 39 pikë, duke bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, krahasuar me vitin paraprak kur ka qenë në vendin e 95 me 36 pikë

**EPOKA  
ERE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të enjten ka publikuar rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017 të Transparency International, sipas të cilit, Kosova ka shënuar progres prej dhjetë pozitash në krahasim me vitin e kaluar.

Në një konferencë për medie, Majlinda Kurti nga KDI-ja ka thënë se Kosova është radhitur e 85-ta me 39 pikë, që do të thotë se ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, krahasuar me vitin paraprak kur ka qenë në vendin e 95 me 36 pikë. "Kosova është radhitur në pozitën e 85-të, që nënkupton përparim prej dhjetë vendesh në krahasim me vitin paraprak kur ishte e renditur e 95-ta. Ndonëse në pozicion më të mirë se në vitin e kaluar, Kosova me 39 pikë ende ndodhet nën mesataren globale prej 43 pikësh. Një gjetje tjetër interesante me vendet e rajonit është se Kosova ka kaluar Shqipërinë, Maqedoninë dhe Bosnjën, kurse mbetet prapa Malit të Zi dhe Serbisë në luftën kundër korrupsionit", ka deklaruar Kurti.

Ndërsa Arben Kelmendi nga KDI-ja ka treguar se, sipas hulumtimit të Transparency International, Kosova ka shënuar

progres në fushën e drejtësisë, të medieve dhe të luftës kundër korrupsionit. "Tek pavarësia e sistemit të drejtësisë raporti konsideron se ndryshimet kushtetuese sigurojnë që shumica e anëtarëve të KPK-së dhe KGJK-së zgjedhen nga kolegët e tyre gjyqtarë, përkatësisht prokurorë, e paraqet ngritje të nivelit të pavarësisë së drejtësisë kosovare. Një tjetër dëshmi e rritjes së pavarësisë konsiderohet fakti që ministri i Drejtësisë nuk është anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Fatkeqësisht, raporti pranon se puna e gjyqësorit vazhdon të vuajë nga niveli i lartë i ndërhyrjeve politike", ka theksuar ai. Kurse sa i përket fushës së medieve, Kelmendi ka thënë se raporti evidenton fuqizimin e medieve jo vetëm në bërjen publike të rasteve korruptive, por në presionin që u bëjnë organeve të drejtësisë të reagojnë pas prononcimeve të tilla në media. "Raporti përmend rastet kur organet e drejtësisë kanë reaguar shpejt ndaj kërcënimeve të gazetarëve nga personat e etiketuar në raportimet e tyre", ka thënë Kelmendi.

Ndërsa sa i përket luftës kundër korrupsionit, përparimi i atribuohet kryesisht përmirësimit të legjislatcionit, krimit të grupeve punese dhe mekanizmave përcjellës për



krimet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe rritjes së rasteve të trajtuara nga sistemi i drejtësisë. "Luftimi i korrupsionit vazhdon të mbetet një nga kushtet kryesore që bashkësia ndërkombëtare ua kishte vënë institucioneve të Kosovës në rrugëtimin drejt integritimit në BE", ka theksuar Kelmendi. Megjithatë, ai ka thënë se problem kyç mbetet mungesa e transparencës në shpenzimin dhe menaxhimin e financave publike të subjekteve politike, ku këto të fundit vazh-

dojnë të mos i publikojnë burimet e financave dhe shpenzimet e tyre. "Joprofesionalizmi, ndikimi dhe kontrolli partiak në emërimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, në të gjithë sektorët publikë, në të gjitha nivelet, vazhdon të mbetet pengesë. Pavarësisht prej 'progresit të raportuar' në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, në raportet e fundit nga KDI vetë aktorët e sistemit të drejtësisë e pranojnë se ka nivel të lartë të korrupsionit brenda sistemit,

ndërhyrje politike në punën e gjyqësorit (mungesa e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë) dhe të nepotizmit dhe formave të tjera të favorizimit. Në fushën e prokurimit publik kërkohet ngritje e transparencës, hapja e kontratave, përmirësimi i menaxhimit të kontratave publike dhe ngritja e nivelit të llogaridhënies", ka deklaruar Kelmendi.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është pjesë e Transparency International.

## Delawie i gëzohet progresit që ka bërë Kosova në luftimin e korrupsionit

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, është shprehur i kënaqur me pozicionimin e Kosovës, pas raportit të publikuar nga Transparency International për shkallën e korrupsionit në të gjitha vendet e botës. Pavarësisht prej kësaj, Delawie ka theksuar se renditja e Kosovës në vendin e 85 nuk është e

mjaftueshme. "I gëzuar që po shoh Kosovën të bëjë progres sa i përket korrupsionit. Matjet nga ky raport tregojnë se ka vazhdim të përmirësimit, që është vitale për të ardhmen euroatlantike. Qytetarët e Kosovës meritojnë renditje më të mirë sesa vendi i 85-të", ka shkruar Delawie në llogarinë e vet në "Facebook".

## Haradinaj në takim me Bildt: Kosova po përshpejton procesin e agjendës evropiane



**PRISHTINË, 22 SHKURT (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim ish-kryeministrin suedez dhe bashkëkryesuesin e Këshillit Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare (ECFR), Carl Bildt dhe një delegacion nga Suedia.

Zhvillimet e fundit politike në vend, proceset integruese euroatlantike për Kosovën dhe gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, ishin temat që janë diskutuar në këtë takim, në të cilin kryeministri Haradinaj fil-

limisht ka falënderuar ish-kryeministrin Bildt për ndihmën që shteti i tij ia ka dhënë dhe vazhdon t'ia japë Kosovës.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova po përshpejton procesin e përmbushjes së Agjendës së Reformës Evropiane dhe të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me qëllim të përafrimit me BE-në, me synimin që deri në fund të vitit ta marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në familjen evropiane. Ai ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe

në OKB është i rëndësishëm dhe do të kontribuonte në paqe dhe stabilitet jo vetëm për Kosovën, por edhe për tërë rajonin.

Ndërkaq ish-kryeministri suedez dhe bashkëkryesuesi i Këshillit Evropian për Marrëdhënie Ndërkombëtare (ECFR), Carl Bildt, e ka uruar kryeministrin Haradinaj dhe popullin e Kosovës për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë dhe të arriturat brenda këtyre viteve. Ish-kryeministri suedez u interesua për zhvillime të ndryshme në Kosovë dhe në rajon.

## Rreth 200 mijë fëmijë përfitojnë nga donacioni i IPKO-s

Në kuadër të nismës për ta mbështetur sektorin e shëndetësisë, rreth 200 mijë fëmijë do të përfitojnë nga donacioni i IPKO-s në dhjetë komuna

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Kompania më stabile e telefonisë në Kosovë, IPKO, tashmë ka përfunduar shpërndarjen e pajisjeve mjekësore për dhjetë departamente të pediatrikë nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare. Nëpërmjet një komunikate për medie IPKO ka bërë me dije se donacioni prej 100 mijë eurosh ka për qëllim t'i ndihmojë Qendrat e Mjekësisë Familjare, me pajisjet dhe mjetet më të domosdoshme, të cilat do të jenë në shërbim të fëmijëve të Kosovës.

Nisma "Ne qëndrojmë me fëmijët" ka filluar në Spitalin Rajonal të Prizrenit, për të vazhduar në Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunat e tjera, si: Ferizaj, Obiliq, Skenderaj, Drenas, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Graçanicë dhe Klinë.

Drejtori ekzekutiv i IPKO-s,

Robert Erzin, ka thënë se kjo kompani do të vazhdojë me projekte të ngjashme edhe në të ardhmen. "Është e një rëndësie të veçantë që të krijohen kushte më të mira të jetës për fëmijët në Kosovë, njëkohësisht t'u afrojmë atyre më të mirën nga ne. Donacioni i IPKO-s është dhënë duke u bazuar në nevojat e Qendrave të Mjekësisë Familjare, gjegjësisht repartëve pediatrike të tyre. IPKO është kompani që mban përgjegjësi sociale, duke e kthyer investimin e saj në shoqëri. Është obligim yni i përbashkët si shoqëri, që të kujdesemi për fëmijët e vendit. Ne qëndrojmë me fëmijët e Kosovës dhe do të vazhdojmë me projekte të ngjashme edhe në të ardhmen", ka thënë Erzin.

IPKO vazhdimisht përkrah kauza të ndryshme që kanë të



bëjnë me fëmijët.

Në fund të vitit 2017 IPKO ka përfunduar projektin e

shkollave "Mësimdhënësit zgjedhin, IPKO përkrah". Nga ky donacion kanë përfituar 50

shkolla, kopshte të fëmijëve dhe njësi të tjera arsimore, kryesisht nga zonat rurale.

## OEAK-u: Niveli i korrupsionit në shëndetësi dhe arsim mbetet i lartë

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Korrupsioni vazhdon të mbetet në nivel të lartë si në sektorin e shëndetësisë, po ashtu edhe në arsim si pasojë e mungesës së vullnetit politik në nivelet më të larta institucionale. Kështu u tha të enjten në një debat të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me titullin "Korrupsioni në arsim dhe shëndetësi".

Arian Zeka, drejtor ekzekutiv i Odës Amerikane në Kosovë, ka thënë se pavarësisht prej përparimit në luftën kundër korrupsionit, kjo dukuri vazhdon të mbetet në nivel të lartë. "Duhet shtuar përpjekjet në të gjitha hal-



llat e luftimit të korrupsionit për rezultate më të efektshme në këtë aspekt", është shprehur Zeka.

Ndërsa Patrick Etienne nga Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë ka thënë

se pasojat e korrupsionit në shëndetësi po ndikojnë në shërbime të cilësisë më të ulët. "Problemi kryesor qëndron tek institucionet e larta shtetërore tek të cilat interesi privat mbizotëron atë publik", ka deklaruar Etienne. Dukagjin Pupovci, drejtor i Qendrës për Arsim të Kosovës, tha se sistemi korruptiv në punësimin e personelit arsimor mbetet shqetësues si në nivelet komunale, po ashtu edhe në ato ministore. Po ashtu, ai ka përmendur korrupsionin në paga në institucionet e larta arsimore, duke theksuar se nxjerrja e paralajmëruar e ligjit mbi pagat do të ndihmonte në eliminimin e disa prej proble-

meve.

Ndërsa përfaqësues të shoqërisë civile konsiderojnë se që nga paslufta sistemi arsimor ka degraduar si në mungesën e investimeve për arsimin si fushë me prioritet, po ashtu edhe mungesën e zhvillimit të ligjeve. Organizata ndërkombëtare Transparency International në raportin e publikuar të mërkurën për Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2017, e ka radhitur Kosovën në vendin 85-të, me 39 pikë, që do të thotë se ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, krahasuar me vitin paraprak kur ka qenë në vendin e 95-të me 36 pikë.

## Beqaj: Do t'i mbështesim idetë dhe ndërmarrjet që kanë vizion të qartë

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka vizituar kompaninë "Gjirafa.com", me ç'rast ka parë nga afër punën e kësaj kompanie. Beqaj ka thënë se mjafton vetëm një ide e mirë dhe një ekip si i "Gjirafa.com" për të bërë revolucion në hapësirën digjitale shqiptare. "Kanë mjaftuar pak muaj që 'Gjirafa' të shndërrohet nga një ide e mirë, në një biznes që sot punëson dhjetëra të rinj të talentuar. Ky grup i të rinjve po e transformon mënyrën se si ne blejmë, si

kërkojmë online dhe se si i gjejmë produktet, bizneset dhe përmbajtjen më të mirë online", ka deklaruar ministri Beqaj. Ai ka shtuar se ka edhe shumë gjëra të reja që po vijnë nga kompania "Gjirafa". "Si Ministri e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të kujdesemi që t'i mbështesim idetë dhe ndërmarrjet që kanë vizion të qartë. Prandaj, mos hiqni dorë nga idetë tuaja që jua realizojnë ëndrrat tuaja për zhvillim personal e profesional. Ne jemi këtu për ta dhënë mbështetjen tonë", ka thënë ministri Beqaj.





# Ministri Hamza kërkon nga ministritë t'i implementojnë projektet



Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Bankës Botërore kanë diskutuar të enjten me të gjitha ministritë dhe agjencitë e linjës për rishikimin e portofolit kreditor. Me këtë rast, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka kërkuar nga të gjitha ministritë implementuese të projekteve dinamizëm më të shtuar në procesin e implementimit të projekteve dhe përkushtim në shpenzim transparent dhe efektiv të fondeve të huamarrjes

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 22 SHKURT - Në vazhdim të aktiviteteve të Ministrisë së Financave për ta monitoruar implementimin e projekteve që

financohen nga huamarrja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të enjten Ministria e Financave, së bashku me Bankën Botërore, kanë organizuar një tryezë me të gjithë ministrat dhe sekretarët të cilët, në kuadër të ministrive të tyre, imple-

mentojnë projekte me financim nga huamarrja nga Banka Botërore. Qëllimi i tryezës ishte që diskutimet të kontribuojnë më tutje për ngritjen e vetëdijes dhe të përkushtimit të secilit përgjegjës në kuadër të ministrive dhe agjencive të linjës, për implementim sa më efektiv dhe efikas të të gjitha projekteve në fjalë. Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se projektet me financim përmes huamarrjes/kredive shtetërore bartin koston e tyre financiare mbi shumën e shpenzuar e që është interes, por edhe tarifa të tjera të aplikueshme mbi shumën e patërhequr. "Prandaj, implementimi me kohë i projekteve kursen buxhetin e Kosovës në njërin anë, në të njëjtën kohë

implementimi efikas i tyre kontribuon në rritje ekonomike", ka thënë ai. Me këtë rast, ministri Bedri Hamza ka kërkuar nga të gjitha ministritë implementuese të projekteve dinamizëm më të shtuar në procesin e implementimit të projekteve dhe përkushtim në shpenzim transparent dhe efektiv të fondeve të huamarrjes. "Gjithashtu, implementimi me kohë i projekteve aktuale krijon mundësi të reja për Ministrinë e Financave që, karshi Bankës Botërore, të kërkojë fonde shtesë me kushte të favorshme kreditorë dhe të financojë projekte të tjera zhvillimore për Kosovën", është shprehur ministri Hamza. Ndërsa shefi i Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë, Marco

Mantovanelli, gjatë takimit me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës si palë implementuese të projekteve përkatëse të cilat financohen përmes huamarrjes nga Banka Botërore, tha se Banka Botërore ka qenë dhe do të jetë e gatshme ta ndihmojë Kosovën në fusha të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin e saj. "Ndërsa takimet për të diskutuar për projektet të cilat janë në implementim e sipër janë të mirëseardhura. Institucionet e Kosovës duhet t'i rrisin angazhimet e tyre për t'i përfunduar projektet sipas dinamikës së paraparë, për të vetmen arsye se këto projekte kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve të vendit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve", ka thënë Mantovanelli.

## Ndikimi i një projekti të ri për integrimin e rrjeteve mes rajonit dhe BE-së

TRANË, 22 SHKURT - Një projekt i ri integrimi të rrjeteve të transportit në mes të Ballkanit dhe Bashkimit Evropian (BE) pritet të sjellë donatorë dhe mundësi financimi edhe në Shqipëri. Integrimi progresiv i rrjeteve të transportit në mes të BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë, Mali të Zi, Serbisë dhe Kosovës, do të bëhet përmes komunitetit të transportit, një institucion që do t'i koordinojë projektet rajonale

dhe zbatimin e legjislacionit evropian për të gjitha llojet e transportit: rrugor, detar, hekurudhor dhe ajror.

Selia është zgjedhur në Beograd dhe Shqipëria e firmosi traktatin në samitin për Ballkanin Perëndimor në Trieste. Traktati do të përfshijë mundësi financimi nga donatorë dhe Institucione Financuese Ndërkombëtare, në veçanti nëpërmjet Kuadrit të Investimeve të Ballkanit. Tri janë projektet kryesore rrugore ku përfshihet Shqipëria. "Korridor

Adriatiko-Jonian, më tej është 'Rruga 7', që është lidhja e Prishtinës nëpërmjet Morinës me Portin e Durrës, si edhe Korridori 8", ka thënë Thimio Plaku nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë.

Tani për tani projekti i vetëm ku Shqipëria ka përfituar financime nga fondi i BE-së për Ballkanin Perëndimor është rehabilitimi i hekurudhës Tiranë - Durrës. Fatura është rreth 90 milionë euro, një pjesë e së cilës është përfituar falas.



## ShBA-ja rinovon një shkollë në Vushtrri

**VUSHTRRI, 22 SHKURT** - Zëvendëseshfja e misionit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Colleen Hyland, ka vizituar të enjten komunën e Vushtrrisë pas renovimit të shkollës "Bahri Haxha" në këtë komunë. Në kuadër të këtij aktiviteti ajo është pritë në një takim njohës nga kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, nënkryetari Besim Muzaqi dhe drejtori i Arsimit, Afrim Namani. Në emër të qytetarëve të Vushtrrisë, Tahiri ka falënderuar

Hyland, popullin amerikan për mbështetjen që po i jep popullit të Kosovës. Po ashtu, kryetari Tahiri e ka njoftuar Hyland për prioritetet e qeverisjes së re në Vushtrri dhe është pajtuar për vazhdim të bashkëpunimit edhe në të ardhmen. Në kuadër të programit për ndihma humanitare të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, Zyra për Bashkëpunim në Mbrojtje pranë Ambasadës Amerikane në Prishtinë ka investuar në rinovimin e shkollës "Bahri Haxha".



## Universiteti 'Isa Boletini' pranohet në Rrjetin Evropian për Integrim Akademik



**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" është pranuar në Rrjetin Evropian për Integrim Akademik (ENAI). Për këtë ka vendosur Bordi i Rrjetit Evropian për Integrim Akademik (ENAI), që mbështet nga programi Erasmusplus dhe Unioni Evropian.

Ylber Januzaj, këshilltar i rektorit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", ka thënë se anëtarësi mi në këtë rrjet është shumë i

rëndësishëm. "Në këtë rrjet ndërkombëtar bëjnë pjesë universitete me renome botërore, prandaj pa dyshim se ky është një lajm i mirë për Universitetin tonë", ka deklaruar ai. Sipas tij, përfitimet nga ky rrjet janë të shumta. "Bërja pjesë e platformës bashkëpunuese të ENAI-të, e drejta e organizimit të konferencave dhe ngjarjeve të ENAI-të, e drejta e votës së Universitetit në zgjedhjen e bordit të ENAI-të dhe ndikimi i Universitetit në këtë

rrjet", është shprehur Januzaj.

Ai ka numëruar si përfitim edhe përdorimin e konsulentëve, ekspertëve, mentorëve dhe folësve të ENAI-të, shfrytëzimin e veglave të dobishme të marketingut, qasjen në burime dhe në programe trajnimi online si dhe pranimin e rregullt të lajmeve të reja mbi fushën akademike. Januzaj ka theksuar se objektiva kryesore e ENAI-të është promovimi i integritetit në fushën akademike.

## Kosovarët e Stambollit, të gatshëm ta ndihmojnë Malishevën

**MALISHEVË, 22 SHKURT** - Në kuadër të vizitës zyrtare në Turqi, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, baskë me drejtorin e Bujqësisë, Murat Hoxha dhe anëtarin e Kuvendit Komunal të Malishevës, Faik Zogaj, janë takuar me anëtarët e Shoqatës Kulturore "Kosovalilar" si dhe me kryetarin e kësaj shoqate, Murat Beg, me të cilët kanë biseduar për shumë çështje.

Në mesin e kosovarëve në Stamboll, Begaj është takuar edhe me Qazim Agushin, pasardhës i familjes së Iliaz Agushit nga Malisheva. Në këtë takim anëtarët e Shoqatës "Kosovalilar" i kanë dhënë mbështetje kryetarit Begaj dhe kanë thënë se do të angazhohen maksimalisht për Kosovën, në veçanti për Malishevën. Ata i kanë premtuar Begajt se do të kërkojnë nga kompanitë

investuese në Stamboll që të investojnë në Malishevë, sidomos nga kompanitë, pronarët e të cilëve janë me prejardhje nga Kosova. "Takimi me anëtarët e kësaj shoqate kulturore të kosovarëve në Stamboll ishte shumë miqësor dhe ata janë shprehur shumë të kënaqur që vizitohen nga institucionet tona", ka thënë drejtori i Drejtorisë për Bujqësi në Malishevë, Murat Hoxha.



## Jashari takohet me dy zyrtarë britanikë, flasin për zhvillimin ekonomik



**SKENDERAJ, 22 SHKURT** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritë të enjten në takim Samuel Paice, shef i Seksionit të Demokratizimit dhe Sundimit të Ligjit nga Ambasada e Britanisë dhe Fiona Henry, zyrtare për Kosovën në Ministrinë e Punëve të

Jashtme të Britanisë. Gjatë këtij takimi është diskutuar për gjendjen aktuale dhe zhvillimet ekonomike në Komunën e Skenderajt. Ndër të tjera, është diskutuar edhe për planet zhvillimore, për sfidat si dhe për prioritetet e qeverisë lokale të

Skenderajt.

Fiona Henry ka përgëzuar kryetarin Jashari për detyrën, duke i dëshiruar sukses dhe rugëtim të mbarë në këtë mandat qeverisës. Në fund të këtij takimi kryetari Jashari ka nderuar dy mysafirët me nga një dhuratë simbolike.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (11)

# ADEM DEMAÇI, VLERË MADHORE E UÇK-së

**Selatin NOVOSELLA**

231. Sabile Keçmezi-Basha, punë-tore Shkencore e Institutit të Historisë së Kosovës "Ali Hadri": Të mësojmë nga shembulli i Adem Demaçit

Të nxjerrim mësimet të rëndësishme nga përpjekjet shekullore të popullit tonë, të marrim shembull nga Bacë Adem Demaçi dhe të ngremë lartë vlerat tona kombëtare e njerëzore, kodin tonë të lartë etik e moral.

232. Sabit Ratkoceri, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Për Adem Demaçin ishte rezervuar dënimi kapital

Në vitin 1964, si anëtarë të organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", Gjykata e Qarkut e Prishtinës na ka gjykuar me këto dënime: Adem Demaçi 15 vjet burgim të rëndë, Sabit Ratkoceri 11 vjet burgim të rëndë, Hazir Shala 13 vjet burgim të rëndë, Selahudin Daci 10 vjet burgim të rëndë, Azem Beqiri 10 vjet burgim të rëndë, Abdyl Lahu 10 vjet burgim të rëndë, Ahmet Haxhiu 10 vjet burgim të rëndë, Xhafer Mahmutxhikun 11 vjet burgim të rëndë, Dibran Bajraktari 13 vjet burgim të rëndë, Sabri Novosella 9 vjet burgim të rëndë, Tefik Sahiti 9 vjet burgim të rëndë dhe Njazi Straja 9 vjet burgim të rëndë.

233. Sabit Sylja, drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës "Ali Hadri": Adem Demaçi synonte të ngrinte urat e mirëkuptimit

Si të rrallëkush, që kishte vuajtur aq shumë, asnjë mëri, urrejtje e hakmarrje, nuk u vu re te Adem Demaçi, për askënd, as për serbët... Synonte t'i ngrhte urat e mirëkuptimit, si të vetmet që do të evropianizonin vërtet e përfundimisht Ballkanin.

234. Sabri Kijçmari, veprimtar i daluar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi nuk dëshiron ta luaj rolin e heroit

Adem Demaçi nuk dëshiron ta luaj rolin e heroit. Pikërisht kjo sjellje ia shton edhe më shumë madhështinë prej heroit, deshi apo nuk deshi ai, e pranoi apo nuk e pranoi ai. Ai është hero i gjallë. Është hero i lirisë, i ndërgjegjes, i drejtësisë, i pavarësisë, i kombit. Ai është legjendë e gjallë.

235. Sadri Fetiu, drejtor i Institutit Albanologjik i Prishtinës: Adem Demaçi, atdhetar dhe politikan i mirëfilltë

Adem Demaçi, atdhetar dhe politikan i mirëfilltë, i kishte këputur të gjitha lidhjet me muzat, krejt papritmas, befasisht, paraqitet

romani i tij i ri "Libër për Vet Mohimin". Ky roman, brenda një kohe relativisht të shkurtër, është përkthyer edhe në disa gjuhë të huaja.

236. Sadri Ramabaja, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi dhe Metush Krasniqi si dy krahë të shqipes

Në rrethana të vështira historike në skenën politike shqiptare, na paraqiten dy organizata, si dy krahë të shqipes dhe dy liderë që do të shihen e njihen për herë të parë në Burgun e Nishit. Fjalën e kam për "Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", në krye të së cilës do të vihej Adem Demaçi dhe "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë", në krye të së cilës ishte Metush Krasniqi, një pasues i denjë dhe kuptimplotë i Hasan Prishtinës.

237. Salajdin Salihu, profesor në Universitetin e Tetovës: Adem Demaçi nuk pranoi të ishte pjesë e inteligjencës shtetërore

Adem Demaçi nuk zgjodhi heshtjen, por rebelimin kundrejt një sistemi të gjenjeshërt shoqëror dhe politik. Ai nuk pranoi të ishte pjesë e inteligjencës shtetërore. Nuk pranoi pjesëmarrjen në një botë hipokrite: ku duhej që të shkruaje atë që s'e mendoje dhe të mendoje atë që kishte frikë ta shkruaje.

238. Sali Bytyçi, punëtor Shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës: Për Adem Demaçin poetët kanë shkruar poezi më shumë se gjysmë shekulli

Si personaliteti më i shquar i lëvizjes kombëtare shqiptare në Kosovë në pjesën e dytë të shekullit njëzetë, Adem Demaçi është epitëzuar, personifikuar dhe simbolizuar në vargje, por edhe është kthyer në mit më shumë se çdo personalitet tjetër, i çdo fushe. Për dekada me radhë, poet të njohur e anonim, të vjetër e të rinj, kanë krijuar vargje për Bacën, për simbolin e rezistencës shqiptare për më shumë se gjysmë shekulli në ish-Jugosllavi.

239. Sali Kabashi, publicist: Adem Demaçi është legjendë

Adem Demaçi, njeriu me stazh burgimi më të gjatë në botë, nuk është e nevojshme ta paraqesim në ndonjë mënyrë të posaçme. Adem Demaçi është legjendë.

240. Sami Dërmaku, i gjykuar së bashku me Adem Demaçin në burgun e tretë, në vitin 1975: Adem Demaçi, vullkan i pashuar

Adem Demaçi ishte flamurtar-Flamur, që frymëzoi të gjitha generatat patriotike të Lëvizjes Ilegale. Me emrin e Adem Demaçit shkohej edhe deri në vdekje për idealin e madh të lirisë. Adem Demaçi dinamik, Adem Demaçi i befasueshëm, Adem Demaçi vullkan i pashuar, Adem Demaçi është ai që shkatërroi themelet e regjimit diktatorial serbo-jugosllav.

241. Sefedin Fetiu, shkrimtar: Adem Demaçi, shembull ekzem-

plar i pajtimit të plotë të aktit jetësor me veprën artistike

Shembulli më ekzemplar, rasti më unik në letërsinë tonë e krejt i rrallë në letërsinë e përbotshme sa i përket dukurisë së përputhjes, shkrires, të pajtimit të plotë të aktit jetësor me veprën artistike, është shkrimtari ynë i mirënjohur, autori martir, i çmuar dhe i adhuruar - Adem Demaçi.

242. Sejdi Gega, veprimtar i çështjes kombëtare: UDB-ja nuk arriti ta vras e ta heshtë zërin e Adem Demaçit

Edhe pas shumë burgosjeve dhe dënimeve të gjata, UDB-ja nuk arriti ta vras e ta heshtë zërin e Adem Demaçit që nuk ishte tjetër pos "Zëri i Kosovës" - zëri i shqiptarëve. Kështu, Adem Demaçi dhe "Zëri i Kosovës" do të bëhen burim i pashtershëm frymëzimi dhe inspirimi për të gjitha gjeneratat.

243. Selatin Novosella, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi, njeriu më me fat në historinë e Kosovës

Adem Demaçi u lind në kohën e Aleksandër Karagjorgjeviqit (1936); filloi veprimtarinë atdhetare në kohën e Aleksandër Rankoviqit (1958); arriti kulmin e veprimtarisë në kohën e Josip Broz Titos (1964) dhe përfundoi me çlirimimin e Kosovës në kohën e Slobodan Milosheviqit (1999). Një rrugë të tillë jetësore dhe një fat të tillë rrallëkush e ka në historinë tonë kombëtare.

244. Selatin Novosella, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi, kampion i burgjeve të Jugosllavisë

Adem Demaçi është dënuar tri herë për veprimtari atdhetar - politike nga pushteti jugosllav.

Herën e parë, në vitin 1958, është dënuar 5 vite burgim të rëndë, herën e dytë në vitin 1964 është dënuar 15 vite burgim të rëndë dhe, herën e tretë, në vitin 1975, po ashtu, është dënuar 15 vite burgim të rëndë. Nga 35 vite sa është dënuar i ka vuajtur 28 vite burgim, prej tyre mbi 4 vite i ka vuajtur në vetmi të plotë.

245. Selman Hoxha: Adem Demaçi flet edhe kur hesht

Adem Demaçi nuk ka nevojë për mbrojtje dhe avokat. Ai vetë është gjallë dhe i fortë. Ai flet edhe kur hesht. Jeta dhe vepra e tij jetësore janë libër i hapur për të gjithë ata që duan ta njohin dhe kuptojnë të vërtetën.

246. Samjl Latifi, kryetar i Komunes së Rahovecit: Adem Demaçi ka thënë: "Unë bëra vetëm punën time"

Ne duhet t'i jemi mirënjohës Adem Demaçit dhe të gjithë atyre që vuajtën nëpër dhomat e hetuesisë së UDB-së jugosllave, të gjithë atyre që kaluan vitet më të mira të jetës nëpër qelitë e burgjeve serbe. Adem Demaçi dhe të gjithë ata që me vetëdije i hynë rrugës së vetëflimit për atdhe, do të thonë me modestinë e tyre: Ne e bëmë vetëm punën tonë!

247. Steven Erlanger: Adem Demaçi kaloi 28 vjet burg për besimin e tij të zjarrtë për pavarësinë e Kosovës

Adem Demaçi, shpesh i quajtur Nelson Mendela i Kosovës, ka gjetur një lloj të qetësisë dhe modërimin të njëjtë, duke i nxitur bashkëkombësit e tij shqiptarë të përdorin dhuratën e tyre të papritur të lirisë për të ndërtuar një shoqëri të civilizuar në Kosovë. Zoti Demaçi ka shpenzuar më

shumë se 28 nga 64 vitet e tij në burgjet Jugosllave për besimin e tij të zjarrtë në pavarësinë e Kosovës. 248. Sylë Arifi, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, vlerë madhore e UÇK-së

Adem Demaçi si përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një ndër autoritetet më të vlerësuara jo vetëm të përmasave kombëtare por edhe të atyre ndërkombëtare. Sakrificat, vuajtjet dhe përpjekjet e tij titanike, pa dyshim, e ndihmuan fuqishëm çlirimimin dhe formimin e shtetit të Kosovës. Demaçi është vlerë madhore e UÇK-së dhe e luftës sonë çlirimtare. Adem Demaçi është emblemë e shqiptarizmit. Ai, për shqiptarët, ka qenë dhe ka mbetur alfa dhe omega se si duhet dashur atdheu dhe si duhet sakrifikuar për të. Burgosja 28-vjeçare e Adem Demaçit nuk ishte vetëm skemë e skenarëve të UDB-së, por edhe e elitës shqipfolëse në sistemin sllavo-komunist.

249. Sylë Ukshini, ambasador i Kosovës në Shqipëri: Me Adem Demaçi Përfaqësues Politik i UÇK-së, u manifestua një akceptancë më e madhe politike në Evropën Perëndimore

Me ardhjen e Adem Demaçit në postin e Përfaqësuesit Politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe me fillimin e ristrukturimit të brendshëm të UÇK-së, dhe si rrjedhim i fleksibilitetit të saj politik, ndaj kryengritësve dhe luftës së tyre u manifestua një akceptancë më e madhe në kancelaritë europereëndimore.

250. Sylejman Selimi, komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi, frymëzues dhe ideolog i lirisë

Natyrshtëm Adem Demaçi reflekton një jetë të tërë të luftës për liri dhe barazi kombëtare e njerëzore. Jam kërenar që po jetoj në kohën e Adem Demaçit, frymëzuesit dhe ideologut të lirisë dhe të qëndrësës kombëtare.

252. Shaip Beqiri, shkrimtar: Adem Demaçi, prijësi i përjetshëm i bashkimit kombëtar

Udhën që kishte nisur i vetëm prijësi i përjetshëm, Adem Demaçi, i cili idenë e lirisë dhe të bashkimit kombëtar e ngriti më lartë se askush tjetër në gjithë historinë aq shumë pjesëtarë të tjerë, pa u ndalur kurrë, pas flamurit që kishte ngritur Adem Demaçi.

253. Shefik Shkodra, shkrimtar: Adem Demaçi, personalitet frymëzues

Adem Demaçi, një personalitet frymëzues i gati të gjithë brezive deri më sot, pa ia numëruar të gjitha vuajtjet, kapërcimet e tyre nëpër kohë, si dhe vetitë e tij prej njeriu të formuar, ai vlen të emërohet president i Kosovës me një konsensus të partive dhe personaliteteve të vendit.

**(Vijon)**

## Shtëpia e Bardhë shqyrton sanksione shtesë ndaj Ruisë

WASHINGTON, 22 SHKURT - Zyrtarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë thonë se administrata Trump po shqyrton vendosjen e sanksioneve shtesë kundër Ruisë lidhur me ndërhyrjen e saj në zgjedhjet presidenciale të 2016-s. Njoftimi vjen mes kritikave nga demokratët dhe republikanët se presidenti Trump ende nuk

ka vendosur sanksione kundër Ruisë, të miratuara tashmë nga Kongresi. Por, zyrtarët thonë se procesi i sanksioneve lëviz ngadalë për arsye ligjore dhe se administrata nuk mund të reagojë shpejt për shkak të titujve negativë kritikave në media.

Komentet erdhën pas deklaratave të bëra nga drejtori

i Shërbimit Kombëtar të Zbulimit, Dan Coats, i cili u tha ligjvënësve javën e kaluar se Rusia ka në plan të ndërhyjë në zgjedhjet e këtij nëntori, pas ndërhyrjes në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Presidenti ende nuk e ka dënuar plotësisht Moskën për ndërhyrjen në zgjedhjet amerikane.



## Merkeli: Marrëveshja për Qeverinë e re gjermane do të jetë e mirë për BE-në

Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se marrëveshja do të ofrojë impulse esenciale për reformimin e bllokut dhe se marrëveshja e koalicionit është e para e këtij lloji që fokusohet shprehimisht në politikën ndaj BE-së

BERLIN, 22 SHKURT - Angela Merkel iu drejtua Bundestagut gjerman një ditë para takimit joformal të liderëve të 27 shteteve anëtare të BE në Bruksel. Forcimi i Bashkimit Evropian është një element qendror i marrëveshjes midis dy partive më të mëdha të Gjermanisë. Merkeli tha se marrëveshja do të ofrojë impulse esenciale për reformimin e bllokut. Ajo theksoi se marrëveshja e koalicionit është e para e këtij lloji që fokusohet shprehimisht në politikën ndaj BE-së. "Duhet të jemi të përgatitur për t'i mbështetur iniciativat kur ato janë më të përshtatshme se zgjidhjet nacionale", tha kancelarja.

Për temën e refugjatëve, Merkeli tha se politika duhet të fokusohet në luftimin e arsyeve pse njerëzit e braktisin atdheun e tyre për të ardhur në Evropë. Ajo theksoi se

përpjekje më të mëdha nevojiten për t'i shkatërruar rrjetet e trafikantëve të njerëzve. Edhe marrëveshja e koalicionit me SPD-në e mbështet një politikë të përbashkët të BE për refugjatët. Merkeli kërkoi që të forcohet në mënyrë masive agjencia evropiane për Mbrojtjen e Kufirit, "Frontex".

Kancelarja kërkoi më tej një riorientim të financave të Bashkimit Evropian. "Debatimi për kuadrin e ardhshëm financiar është edhe një shans për t'i verifikuar në përgjithësi financat e BE-së", tha Merkeli në deklaratën e saj para Bundestagut. Ajo dëshiron një "Evropë të aftë për të vepruar, solidare dhe me besim në vetë". Sot (e premte) kryetarët e shteteve dhe të qeverive të BE-së do të diskutojnë pa Britaninë e Madhe për planin afatmesëm financiar të BE-së nga 2021 deri



© Reuters/A. Schmidt

2027. Ajo pret një diskutim për detyra të reja dhe një mbrojtje evropiane të kufirit. "Kemi nevojë për një zgjidhje për Evropën", tha Merkeli. Njëkohësisht ajo la të kuptojë se priten konflikte me shtetet lindore të BE-së, sepse në fondet strukturore duhet të merret parasysh në të ardhmen edhe

angazhimi për pranimin e refugjatëve. "Solidariteti nuk mund të jetë rrugë me një drejtim në BE", tha ajo. Shkaku për këtë deklaratë është refuzimi i disa shteteve të Evropës Lindore që të pranojnë refugjatët nga shtetet e tjera të BE-së. Vende si Polonia janë përfutuese neto të shër-

bimeve të BE-së. Gjermania është një pagues neto. Merkeli tha se në reformën e Eurozonës në të ardhmen përgjegjësia dhe kontrolli duhet të jenë në një dorë. E rëndësishme është në radhë të parë që të përmirësohet aftësia për konkurrencë në Eurozonë.

## Vazhdojnë bombardimet në Goutan Lindore



DAMASK, 22 SHKURT - Avionët luftarakë kanë bombarduar në Goutan Lindore - enklavën e fundit të rebelëve, që gjendet në afërsi të kryeqytetit sirian, Damask - për të pestën ditë me radhë, përderisa Kombet e Bashkuara kanë bërë thirrje për ndalimin e sulmeve ajrore. Më shumë se 300 predha kanë goditur Goutan Lindore, duke vrarë 13 persona dhe plagosur mbi 100, ka njoftuar të enjten Vëzhguesi sirian për të Drejtat e Njeriut, organizatë me bazë në

Londër. Që prej 18 shkurtit mbi 300 persona janë vrarë në Goutan Lindore, ndërkaq qindra të tjerë janë plagosur. Grupi monitorues, por edhe agjencitë e ndihmës kanë thënë se avionët rusë dhe sirianë kanë goditur spitalet dhe objektiva të tjerë civilë. Sulmet vijnë pasi sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, ka bërë thirrje për ndalim të menjëhershëm "të të gjitha aktiviteteve të luftës" në

këtë zonë, dhe sipas tij, situata në Gouta Lindore është "ferr në tokë". Ndërkaq kancelarja gjermane Angela Merkel i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian, të rrisë trynininë mbi Rusinë dhe Iranin, që t'i jepet fund dhunës në Siri. "Regjimi nuk po lufton kundër terroristëve, por kundër njerëzve të tij, duke vrarë fëmijë, duke shkatërruar spitale, dhe kjo është masakër e cila duhet të dënohet", ka thënë Merkel gjatë një fjalimi në Parlament.

## Arrestohet lideri opozitar rus Aleksei Navalny

MOSKË, 22 SHKURT - Lideri opozitar rus, Aleksei Navalny, ka thënë se është arrestuar nga policia në Moskë. Navalny ka shkruar të enjten në "Twitter" se policët e kanë prangosur atë teksa ai po dilte nga ordianca e dentistit të tij. Sipas tij, policia i ka kumtuar atij se është i

arrestuar. Ai ka thënë se policia e ka dërguar "diku", por vendndodhjen e saktë nuk e di.

Navalny, një kundërshtar i presidentit rus, Vladimir Putin, ka organizuar protesta dhe ka publikuar raporte që sipas tij, dëshmojnë korrupsionin në elitën udhëheqëse të

Ruisë. Atij i është ndaluar kandidimi i në zgjedhjet presidenciale që do të mbahen më 18 mars, për shkak se më parë ka qenë i dënuar. Ai është arrestuar disa herë për organizimin e protestave dhe ka qëndruar në burg për periudha të shkurtra kohore.



Këndvështrim

# Rrëmbimi i Euridikës, apo arratisje drejt kozmosit të ndjenjave

Agron SHELE


Duke lexuar vëllimin më të ri poetik "Rrëmbimi i Euridikës" të autorit Bilall Maliqi, një vëllim me lirika, kupton se përbrenda gjithë këtij opusi kemi një prurje estetike, e cila i thur lajtmotiv ndjenjës më sublimë e të sinqertë njerëzore, vetë dashurisë. Që në fillim autori qendëron këtë vlerë shpirtërore si ornament dhe ndjenjë e përtëjshpirtshme, ku përmes vargjeve e ngre atë në shkallën më të lartë sipërore, gati hyjnore, dhe e gjithë kjo si frymë e shprehi e atij patosi të madh që ndjek jetën deri në të fundit amshim.

Përmes figuracionit të pasur, simbolikës së përdorur, harmonizimit shpirtëror me atë natyror përftohen forma dhe kuptime të thella sentimentale, grishëse dhe kumbuese për vetë zhanrin poetik të përcjellë. Në mbarë këtë vëllim ndeshim të gjitha stinët, pranverën e lulëzuar por dhe vjeshtën e

përmalluar, zjarrin e prushëzuar të verës, por dhe bardhësinë akullnajore të dimrit dhe e ndërthurur me elementet mitologjike, e cila diku ringre nga valëzimi det një Venerë e diku tjetër përhumb e vdes një Euridikë bëhet dhe më tërheqës për lexuesin, si prurje, gjetje e beftë dhe risi e sjellë.

Autori Maliqi ka kohë që është shfaqur në artin poetik dhe është publikuar në shumë revista e antologji të ndryshme, sprovë kjo që lidhet me pjekurinë e lartë dhe profesionalizmin, shkallë vitaliteti që e konsolidon dhe më tepër përmes veprës së tij më të fundit. Kjo përvojë krijon hapësirën e duhur për të operuar në larminë jetë, për të strukturuar një vepër të mirëfilltë, për të ndjekur një bosht të mirëpërcaktuar dhe për të hedhur ide të qarta në formë dhe përmbytje.

Në sinkron të plotë me përmbytjen dhe vetëdijën e plotësuar modelohet zhanri i përzgjedhur, si formë apriori



dhe hapësirë e pafundme, konkretisht lirizmi poetik, si ngjyrim, muzë, mesazh dhe elokuencë.

Leximi i poezive kalon nëpër shkallë krahasimi dhe shtrirje kohore, simbolikë e ardhur përmes Eratos (Muzë e poezisë erotike), Afërditës (perëndesha e dashurisë), Polihimnia (Një nga nëntë muzat e shenjtja), nimfave të ndryshme etj., dhe e

gjithë kjo për të mitizuar ndjenjën dhe ngritur atë në poltronin më të larta të qiellit.

*"Nga pullazi i kohës  
Rrëshqasin stinët  
Kohët veshin  
E zhveshin lëkurat"*

Në vetëm pak vargje shfaqet një hapësirë kaq e madhe kohore, e cila zbret e ndërron stinët,

vesh e zhvesh lëkurët pemë, gjithmonë në përsiatje, pa ndalim, përherë magjishëm e më me madhësi.

Kështu është dhe dashuria, një ndjenjë që përshkon të gjitha ngjyrat, të gjitha gjendjet, të gjithë akuartitetin tingull, zjarr dhe akull, kolor dhe hijezim që trondit kujtesën, dëshirë e fshehtë dhe pasion.


Në të tjera poezi autori ruan të njëjtën frymë përshkruese, të njëjtin ritëm, një sensualitet që varion varg pas vargu dhe himnizon dashurinë, si vlerë e lartë shpirtërore dhe kuptim i thellë i gjithë perceptimit të ndjesive.

Leximi i këtij vëllimi poetik mbart gjurmë të thella në memorie, të shëtit në fanfarën e një bote që përthyet muzave për të rrezatuar shkëlqimin dhe tejpashmërinë e gjithë atij mediativiteti lirik, të cilin autori Bilall Maliqi e sjell plot dritë, finesë, lakonizëm dhe metafrazë të gjithë kuptimeve dhe vazhdimet të vetë risisë jetë.

## Piktorja Topalli hap ekspozitë në Zvicër

**GJENEVË, 22 SHKURT** - Në Kantonin e Gjenevës është hapur ekspozita "Koha", e piktores nga Ferizaj, Lebibe Topalli. Piktorja Lebibe Topalli në Gjenevë ka ekspozuar 30 piktura të cilat po mirëprehen nga artdashësit dhe nga bashkatdhetarët që jetojnë në Zvicër. "Ekspozita mban temën 'The Time'. "Në këtë ekspozitë kam sjellë 30 piktura që janë ekspozuar në qytetin e Gjenevës", ka thënë Topalli. Ajo ka bërë me dije se të gjitha pikturat janë në tekniken akril në pëlhurë. "Pikturat janë të dimensioneve të ndryshme", është shprehur piktorja Topalli.

Kurse konsulli i Republikës së Kosovës në Gjenevë, Ramadan Avdiu, ka thënë se Lebibe Topalli është një artiste që ka ekspozuar edhe në Francë, ndërsa me ciklin "The Time" vjen në Gjenevë për t'i shpalosur vlerat e artit pamor të Kosovës. Sipas tij, kjo është një pjesë e kulturës sonë evropiane me të cilën duhet të njihet më shumë jo vetëm Zvicra, por edhe kultura evropiane në përgjithësi. "Shkëmbimet kulturore janë mundësi e shkëlqyeshme për t'u njohur më mirë popujt dhe ciklin "The Time" nga artistja Lebibe Topalli e ka mrekulluar këtë vend ekspozitash në Cite du Temps (Qyteti i Kohës) mbi lumin Rona në Gjenevë", ka deklaruar Avdiu. Hapja e ekspozitës është bërë më 18 janar dhe do të jetë e hapur deri më 28 shkurt.



## Hapet 'Ekspozita Bazë' në Muzeun e Kosovës

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Sot (e premte) hapet 'Ekspozita Bazë', e cila është e paraparë në kuadër të aktiviteteve të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe në të cilën do të ekspozohen artefakte dhe koleksione të objekteve të trashëgimisë dhe historisë së vendit tonë.

'Ekspozita Bazë' në Muzeun e Kosovës solemnisht do të hapet nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ku do t'i dhurohet Muzeut të Kosovës edhe Deklarata e Pavarësisë, e cila do vazhdojë të jetë e prezantuar në ambientet e Muzeut të Kosovës.

Një ditë më parë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar Muzeun e Kosovës për t'i parë nga afër përgatitjet që po bëhen për 'Ekspozitën Bazë'. Ministri Gashi e ka vlerësuar punën që është

bërë në përgatitjen e ekspozitës duke e cilësuar si një ngjarje jashtëzakonisht të rëndësishme e cila mundëson sjelljen para opinionit një kujtesë që nga lashtësia e deri në kohët moderne të historisë e të kaluarës sonë.

'Ekspozita Bazë' në Muzeun e Kosovës shpërfaq kronologjinë historike dhe narrativat tematike. Për secilin pavijon janë identifikuar tema emblematike, të cilat materializohen në formë të ekspozateve dhe vijave të përcaktuara të prezantimit.

Ekspozitat që do të prezantohen në këtë ekspozitë datojnë që nga koha e Neolitit deri me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008.

Të gjitha këto janë artefakte të trashëgimisë së luajtshme kulturore të Kosovës dhe pasqyrojnë identitetin kulturor dhe historik të Kosovës.



# Nga 2004 deri më sot, tragjeditë ajrore të 15 viteve të fundit

2017 ishte "më i sigurti" me 10 aksidente fatale. Tragjedia e avionit Lamia 2933 daton që nga viti 2016, u rrëzua se nuk kishte karburant, ndërkohë që ishte në bord me ekipin brazilian të futbollit Chapecoense.

Aeroplani që u rrëzua pranë Moskës me 71 vetë në bord është vetëm tragjedia më e fundit në qiell që vijon më tej me një listë dramatike. Nga viti 2004 deri më sot ka tragjedi të shumta ajrore që kanë ndikuar në aviacionin komercial botëror.

Viti 2017 ishte viti më i sigurt në histori me 10 aksidente fatale dhe 79 viktima. Tragjedia e avionit Lamia 2933 daton në vitin 2016, u rrëzua pa karburant me ekipin brazilian të futbollit Chapecoense në bord. Më poshtë ju kemi listuar tragjeditë ajrore të 15 viteve të fundit.

**2004** – Më 3 janar, një Boeing 737 i fluturimeve ajrore egjiptiane, u largua nga Sharm el Sheik, dhe rrëzohet pas ngritjes: 148 të vdekur, kryesisht turistë francezë.

**2005** – Një shkurt, avionik Kam Air 904, nga Herati në Kabul, rrëzohet mbi një mal në mbi 3000 metra, 104 të vdekur. Në gusht dy aksidente: fluturimi i Helios Airways rrëzohet pranë Athinës dhe vdesin 121 persona. Në Venezuelë, fluturimi i West Caribbean Airways rrëzohet pas një zjarri në motorë: 160 të vdekur.

**2006** – Një avion i Armavia Armish gjatë një uljeje, të gjithë 113 personat që ishin në bord humbasin

jetën. Në korrik, një avion i kompanisë ruse S7 Airlines rrëzohet në rrugën e Irkutskut me 203 njerëz në bord: 125 pasagjerë dhe 8 të ekuipazhit humbasin jetën. Në gusht, një Tupolev i ruse Pulkovo Airlines rrëzohet në Donetsk: vdesin 170 persona.

**2007** – Një avion i Tam Linhas Aereas braziliane shkon në det të hapur në Sao Paulo. 181 pasagjerë, 6 anëtarë të ekuipazhit dhe 12 njerëz në tokë vdesin.

**2008** – Në Madrid, një Spanair MD-82 kap zjarr gjatë ngritjes në Ishujt Kanarie, shkon nga pista dhe ndahet në dy. 154 të vdekur.

**2009** – Avioni i Air France 447 u largua nga Rio drejt Parisit dhe u rrëzua në Oqeanin Atlantik: 228 të vdekur.

**2010** – Në prill një Tupolev-Tu 154 me presidentin polak, Lech Kaczynski, rrëzohet në Smolensk, vdesin 95.

Në maj, një aeroplan i Air India Express lë pistën në Mangalore, 160 të vdekur.

**2011** – Janë 127 viktima të Boeing 727 të linjës Hewa Bora, të rrëzuar në Kisangani.

**2012** – Një fluturim i Nigerian Dana Air rrëzohet në një ndërtesë dy katëshe në Lagos: 163 të vdekur.

**2013** – Më 17 nëntor, Tatarstan Airlines Flight 363, një Boeing 737, rrëzohet gjatë fazës së uljes në aeroportin e Kazanit në Rusi, duke



vararë 50 vetë në bord.

**2014** – Tragjedi e dyfishitë për Malaysia Airlines. MH370 Kuala Lumpur-Pekin misteriozisht zhduket në mars me 239 persona në bord. Më 17 korrik, në qiellin ukrainas, një luftë midis separatistëve Kiev dhe Rusisë, një raketë rrëzon MH17, 298 të vdekur.

**2015** – Më 24 mars Germanwings 9525 rrëzohet në Alpet franceze: 150 të vdekur, duke përfshirë edhe kopilotin Andreas Lubitz, i cili vullnetarisht rrëzon aeroplanin.

**2016** – Më 19 maj avionit MS804 Egyptair Paris-Cairo mbytet. 66 persona në bord. Në fund të nën-

torit, avionit Lamia 2933 përplaslet gjatë qasjes në Medellín pa karburant. Nga 77 persona në bord vetëm 6 mbijetojnë. Ndër pasagjerët është ekipi brazilian i futbollit Chapecoense. Në dhjetor, një aeroplan ushtarak rus që udhëtonte për në Siri bie në Detin e Zi me 92 pasagjerë në bord duke përfshirë edhe grupin Aleksandrov që do të mbante një koncert për trupat.

**2017** – Sipas një studimi, viti më i sigurt në historinë e aviacionit botëror komercial: 10 aksidente fatale me gjithsej 79 viktima. Incidenti më i rëndë në janar 2017, kur një avion turk u rrëzua në një fshat në Kirgistan, duke vararë katër anëtarë të ekuipazhit

dhe 35 persona në terren.

**2018** – Para disa ditësh, një avion me dy motorë "ATR 72-500", i cili po udhëtonte nga Teherani në qytetin perëndimor Yasuj, u rrëzua rreth një orë pasi ishte ngritur në malet "Zagros". Të 66 pasagjerët, bashkë me ekuipazhin e avionit humbën jetën.

Irani ka pësuar disa aksidente ajrore në vitet e fundit dhe ka një flotë të vjetruar avionësh. "Aseman" është kompania e tretë ajrore më e madhe në vend, e nënshkroi vitin e shkuar një kontratë me "Boeing" për të blerë 30 avionet të rinj "737".

(gazeta-Shqip.com)




## Çifti i famshëm i Hollywoodit nis terapinë për ta shpëtuar martesën



Jennifer Anistoni dhe-ish bashkëshorti i saj, Justin Theroux, në shtatë vjetët e tyre të lidhjes janë shfaqur gjithnjë shumë të dashuruar. Por në vitin 2017 ata nisën t'i shfaqin problemet e para në çift, e për këtë arsye nisën terapinë së bashku. Sipas "People",

çifti për disa muaj u përpoq që marrëdhënia e tyre të funksiononte përsëri, e për këtë arsye nisën terapinë. Por edhe kjo përpjekje e tyre dështoi, pasi Jennyferi dhe Justini nuk arritën të krijonin një familje së bashku, duke përfunduar në divorc.

## Pasi "çmendi" Prishtinën, Rita Ora performon këngën e "Fifty Shades Freed"



Pas koncertit të jashtëzakonshëm në Prishtinë, Rita Ora ka dhuruar një tjetër performancë të zjarrtë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve "BRIT Awards". Këngëtarja me origjinë shqiptare ka performuar mbrëmjen e së mërkurës krahe Liam Payne,

këngën e "Fifty Shades Freed", "For You", në skenën e "O2 Arena" në Londër. E veshur me një "body" ngjyrë të bardhë, bukuroshja 27-vjeçare dukej tepër seksi gjatë performimit të duetit, të cilin Liam e finalizoi me një përfaqim dhe një puthje në faqe.



## Dua Lipa triumfon në "Brit Awards 2018"

Dua Lipa ka shkëlqyer dhe triumfuar në ceremoninë e ndarjes së çmimeve "Brit Awards 2018". Ajo ka fituar çmimin si këngëtarja më e mirë femër në Britani dhe atë të këngëtares më të mirë të re. Dua Lipa dhe Strømzø ishin dy fituesit e

mëdhenj në "Brit Award 2018". Të dy lanë pas Ed Sheeran, që humbi në katër nga nominimet; albumin më të mirë, këngëtarin më të mirë mashkull, videon më të mirë dhe singëllin më të mirë. Ndërkaq Gorillaz është përzgjedhur si grupi më i mirë britanik.

## Paris Jacksoni dhe Cara Delevingne në një romancë?

Paris Jacksoni dhe Cara Delevingne kanë ndezur thashethemet për një romancë kur u panë për herë të parë duke dalë nga një klub nate të kapura dorë për dorë në nëntor të vitit të kaluar. Dhe Paris Jackson me Cara Delevingne nuk bënë asgjë për t'i zhdukur këto thashetheme mbi një marrëdhënie midis tyre. Yjet u fotografuan përsëri gjatë një orari të vonë darke në Londër. Ndërsa vajza e mbretit të popit Michael Jackson ka shijuar një darkë me supermodeluesen dhe një grup shokësh, ku shihen të kapura dorë për dorë derisa kthehen në dhomat e hotelit.






							<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	INSTRUMENT MUZIKOR	KËNGËTARI KRASNIQI	I NJËSUAR, I BASHKUAR	"TETOVA"	PËREMËR VETOR	LIGJI, KANUNI (vjet.)	<b>EPOKA ERE</b>	BASHKËT.	SHKRIMTARJA KADARE	BURGU KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA	
							BANOR I NJË QYTETI TË VJETËR NË SHQIPËRI							JO ÇIFT RRALLË (LAT.)				
							DJALLËZOR								NOTË MUZIKORE NËNNDARJE E NJË LIGJI (shq.)			
							LLOJ VETURE FRANCEZE				BANOR I NJË SHTETI AZIATIK FLORI							
							KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË					AKTORJA CAHANI REGJISORI KRYEZIU						
							MIRËQENIE (krah.)							NJËSI PËR TË MATUR FUQINË E RRYMËS ELEKTRIKE	FAMË TONI ADAMS			
							SHEGË				SECILA NGA PJESET E NJË NDËRTESE ALUMIN, LITËR					ZANORE LLOJ MINERALI QË PËRDORËT PËR PLLAKA IZOLIM		
							AKTORJA SUEDEZE MARGRET			MJET LUFTE FUTBOLLISTI SPANJOLL RODRIGUEZ (BARCELONA)						AGIM TEJECI HEROI ..... SEFERI		
<b>EPOKA ERE</b>	ISH FUTBOLLISTI ÇEK JANKULOVSKI (MILAN)	GJERMAN I VJETËR	SHTET NË AZI	QË NUK I PËRKËT FESË DHE KLERIT	INDONEZIA, TANZANIA	MALLKUAR	TREVISO DY BASHKËTINGËLLORE		LLOJ DRURI KRYELARTË					PËREMËR PRONOR KUMBARË				
XHUDISTJA SHQIPTARE NË FOTO																	KËNGËTARJA E NJOHUR PAUSINI	
ANËTARËT E NJË ALEANCE								DY BASHKËTINGËLLORE APARTAMENTI			LETRARI ... ALIU	QË KA TË BËJË ME FSH-ATARËSINË AKTORI ... FLLOKO						
BAKRI GJOJA, KINSE					BASHKËT.		QYTET NË SHQIPËRI LLOJ ËMBËLSIRE						HIT NGA GRUPI "NRG BAND" KUNDREJT BAJAT					
➔					GUR METEORIK TINGULL QË FORMOHET NË MAJË TË GJUHËS									ZET, TON, URANIUM VARG AUTOMJETESH (shq.)				
ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ...				VEND LUFTIMI I GLADIATOR-ËVE ELIZA DUSHKU					KULAÇE PUNËTORI I TETATRIT TË KKUKULLAVE					"IRLANDA" SHKURTABIQ				
<b>EPOKA ERE</b>	NANCY E FRIKËSOJ SHUMË DIKË		ENVER PETROVCI PARAGRAFI			NJË STINË DITA E SHËNJUAR NË KALENDAR				GAZ PËR PASTRIMIN E PLAGËVE FINLANDA, NORVEGJIA					ZANORE DJALË I DJALIT			
ZANORE		MARKË E VESHJEVE SPORTIVE KUZHINA PRANË XHAMISË							NAIM FRASHËRI ZHANËR I MUZIKËS			HOV, VRULL ADRIAN KRASNIQI					PORTET DETARE	
KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM				LLOJ ZOGU KËNGËTAR "RISANI"									ISH BASKETBOLLISTI AMERIKAN SHEKIL ... OSMAN					
PRINCIPATË ARABË (shq.)							OLIVIA MUNN ORGAN I DREJTIMIT TË TRUPAVE USHTARAKE (shq.)				TËRKUZA TURP							
KRYEQYTETI I FILIPINEVE							ARSYE PSE NDODH NJË GJË DY BASHKËTINGËLLORE					TANTAL, METËR BASHKËT.					BASHKËT. SPIUNIA E FAMSHME ... HARI	
KUNDREJT E VJETËR				ESTONIA EMËR MASHKULLI MYSLIMAN		TEFTA TASHKO ASSOCIATION KENYA INSURERS			LETRARI ISMET ... TRANSPORTË AEREO MILITAR					SOLISTJA ... BYTYQI JO I VJETËR				
NUSJA E DJALIT					FILLESTAR ILVA MARE							KLUB FUTBOLLI NË ITALI						
SFOND SHKRONJASH							ÇOBAN BASHKËT.					ANA RUSO ZANORE			TROPOJA, ELBASANI BASHKËT.			
SILIC			KOPJIMI								EKZEMPLAR I VETËM							



E jashtëzakonshme

## Mund të rezervoni dhomë hoteli në hapësirë

Mongoli miliarder i hoteleve, Robert Bigelow, ka në plan t' u japë mundësi njerëzve të rezervojnë hotel në hapësirë deri në vitin 2021. 72-vjeçari, i cili e bëri pasurinë e tij nëpërmjet zinxhirit të hoteleve "Budget Suites of America", thotë se hoteli do të jetë pjesë e një stacioni hapësiror 'përbindësh'.



## BARSOLETA E DITËS



Gjyshi para vdekjes u thotë nipërve:

- Pasi të vdes ma instaloni afër varrit një antenë WiFi.
- Po ç'të duhet, o gjysh?!, - e pyet njëri.
- Që të më vini ndonjëherë te varri, o depsuza!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

## “FERDINAND”

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.  
Regjia: Carlos Saldanha



FOTO E DITES



Në fotografi shihet duke u ngarkuar një elefant në kamion në Solio Ranch në Nyeri County, Kenia. /Reuters/

## Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) “FIFTY SHADES FREED”

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.  
Regjia: James Foley



E rrallë

## Fjeti pranë varrit të pronarit për 11 vjet, ngordh qeni besnik

Një qen besnik i quajtur Capitan, që fjeti në varrin e pronarit të tij çdo ditë për 11 vjet, ka ngordhur. Capitan ishte rreth katër vjet kur Miguel Guzman, i cili e kishte blerë qenin si një dhuratë për të birin, Damian, vdiq në vitin 2006 në Villa Carlos Paz, Argjentinë. Qeni u zhdruk shumë pak kohë më pas dhe familja e tij mendoi se kishte gjetur një shtëpi të re ose e kishin vrarë, por disa muaj më vonë, në një nga vizitat e tyre që bënë te varreza, gjetën qenin Capitan.



Në ora 22:00 (PG-13)

## “THE COMMUTER”

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.




**DASHI**

Ka shumë persona që nuk e pëlqejnë suksesin tuaj dhe ju kanë këshilluar të hiqni dorë nga shumë gjëra. Është mirë të veproni sipas interesit personal.



**DEMI**

Të impenjoheni me gjithçka që ka të bëjë me karrierën tuaj ju ka larguar disi nga familja. Do të dëgjoni mjaft ankesa sot.



**BINJAKËT**

Lërvani të tjerëve ankesat dhe paragjykimet. Ju duhet vetëm të veproni sipas planeve tuaja dhe të mos ndikoheni nga çfarë thuhet rreth jush.



**GAFORRJA**

Sot dëshironi të qëndroni të qetë në ambientin tuaj që ju pëlqen aq shumë. Kjo ditë nuk do të jetë ndonjë ngjarje e veçantë për t'u mbajtur mend.



**LUANI**

Duhet të mbani nën fre krenarinë tuaj dhe ambicien e tepruar sepse në të shkuarën keni bërë gabime që ju kanë kushtuar shtrenjtë.



**VIJGJËRËSHA**

I keni pasur çastet tuaja të lavdisë gjatë paradites së sotme dhe për këtë jeni shumë krenar. Mbrëmja paraqitet e qetë.



**PESHORJA**

Sot do të jetë një ditë e mirë për takime pune ose konkurse shkolle. Fati është në anën tuaj dhe çdo gjë do të përfundojë në favorin tuaj.



**AKREPI**

Sot do të vendosni të kaloni një ditë me miqtë sepse ju duhet mendimi i tyre për një vendim të rëndësishëm që do të merrni.



**SHIGJETARI**

Jeni disi të pakënaqur me disa situata që po ndodhin rreth jush. Do të kërkonit ta gjeni fajtorin, por nuk do të mundni dot.



**BRICJAPI**

Do t'ju vlerësojnë për aftësitë tuaja në punë sot dhe meritat do të jenë si morale ashtu edhe financiare.



**UJORI**

Sot ngjyra juaj është blu dhe do të ndiheni shumë të lirë. Jepini vetes më shumë pushim që të relaksoheni.



**PESHQIT**

Po ju kujtohet koha e kaluar me miqtë dhe keni shumë dëshirë t'i riktheheni përsëri. Kujtime të bukura që thjesht po ju shoqërojnë gjatë ditës.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON ENVERT  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	HULL - SHEFF UTD	GG3+	LA CORUNA - ESPANYOL	1	MAINZ - WOLFSBURG	1
-------------------	------------------	------	----------------------	---	-------------------	---

# Kosova, për befasi ndaj Polonisë

Nga ora 19:00 zhvillohet përballja në mes të Kosovës dhe Polonisë, kurse ylli shqiptar i basketbollit, Dardan Berisha, është mjaft optimist për këtë ndeshje. "Ne i dimë qëllimet tona, por e dimë se nuk do të jetë lehtë. Të gjithë bashkëlojtarët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe kjo na jep motivim të bëjmë sa më mirë në duel me Poloninë. Ne do ta japim 100 % tonë dhe do të përpiqemi të bëjmë befasi për të mposhtur një ekip të fortë siç është Polonia", ka thënë Berisha



skudër të fortë siç është Polonia. "Ne i dimë qëllimet tona, por edhe e dimë se nuk do të jetë lehtë. Të gjithë bashkëlojtarët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe kjo na jep motivim të bëjmë sa më mirë në duel me Poloninë. Ne do ta japim 100 % tonë dhe do të mundohemi të bëjmë një befasi për të mposhtur një ekip të fortë siç është Polonia", ka thënë Berisha, i cili ka një karrierë mjaft të pasur si në basketbollin vendor, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sonte (e premte) përballjet me Poloninë në ndeshjen e cila i takon Dritares së Dytë të Grupit C

të kualifikimeve evropiane të Kupës së Botës "Kina 2019". Pavarësisht prej potencialit që ka skuadra përfaqësuese e Polonisë, trajneri i Kosovës, Brad Greenberg, është mjaft optimist për këtë ndeshje. "Është një shans i mirë për të luajtur në Poloni, pasi

kemi dëgjuar se këtu atmosfera është shumë e mirë. Kundërshtari ynë ka një skuadër shumë të fortë. Aktualisht është i 28-ti në renditjen botërore, por unë besoj se djemtë tanë do ta bëjnë më të

mirën", ka thënë Greenberg. Lidhur me ndeshjen ndaj polakëve ka folur edhe basketbolisti më i mirë shqiptar, Dardan Berisha. Ky i fundit ka premtuar maksimumin për të befasuar një

Ndeshja në mes të Polonisë dhe Kosovës zhvillohet nga ora 19:00 në Wloclawek, kurse më 26 shkurt Kosova do ta ketë edhe përballjen e radhës ndaj Lituanisë në Klaipeda.

# Përfundon aventura e Kosovës në 'PyeongChang 2018'

**PRISHTINË, 22 SHKURT (ER)** - Skitari Albin Tahiri i ka përfunduar garat në Lojërat Olimpikë Dimërore "PyeongChang 2018". Skitari nga Kosova përfundoi i 39 nga 108 garues në disiplinën e slallomit, ku shumë garues u diskualifikuan. Pas dy lëshimeve Albini pati kohën 2:02.93 sekonda. Në lëshimin e parë ai ishte i 48-ti me kohën 1:00.98 sekonda. "Ishte një garë e vështirë, ku shumë garues nuk e përfunduan. Unë ia dola dhe jam i lumtur për këtë. Vendi 39 nuk është i keq. Mund të them se të gjitha garat i përfundova deri në fund dhe ky është sukses. Të jesh gati çdo ditë në borë është lodhje, andaj ju faleminderit të gjithëve këtu dhe atyre në Kosovë për përkrahjen!", ka thënë Tahiri. Ndërsa trajneri i Tahirit, Agim Pupovci, nuk kishte prituri paraqitje të tillë në slallom, pasi disiplinat më të mirë për Albinin janë disiplinat e shpejta. "Ishte gara e fundit. Jemi të kënaqur.



Na ka befasuar me slallom, sidomos me lëshimin e parë, ku shumë garues nuk e përfunduan. Na ka befasuar për të mirë në disiplinat teknike, pasi më shumë kemi prituri në disiplinat e shpejta", ka deklaruar Pupovci. Medaljen e artë e fitoi suedezi Andre Myhrer me kohë 1:38.99 sekonda. E argjenda

shkoi për zviceranin Ramon Zenhauersen (1:39.33 sek), kurse të bronzit e fitoi austriaku Michael Matt, me kohë 1:39.66 sek. Kujtojmë se Albini garoi edhe në katër disiplinat e tjera si: kombinim alpin (vendi 37), lëshim (50), super slallom të madh (47), slallom të madh (56) dhe slallom (39).



# Të shtunën organizohen gara në Gjimnastikë

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Federata e Gjimnastikës e Kosovës (FGJK) nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se në fundjavë do të organizohet gara e radhës zyrtare. Kjo garë organizohet në sallën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë më 24 shkurt nga ora

11:00, kurse organizohet me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Duhet cekur se FGJK-së në krye me kryetarin Besim Halilaj dhe klubet e gjimnastikës janë duke bërë një punë të madhe për zhvillimin e këtij sporti mjaft të dashur në Kosovë.

# Kosovë U 19 barazon me Bullgarinë

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll U 19 ka barazuar 0-0 në miqësoren e dytë kundër Bullgarisë U 19, në ndeshjen që është zhvilluar të enjten në stadiumin "Arena" në Sozopol. Dy ditë më herët të përgjdhurit e Ramiz Krasniqit kishin pësuar humbje nga bullgarët 2-1,

ndonëse pjesën e parë e kishin mbyllur në epërsi 1-0. Kësaj radhe të dyja skuadrat zhvilluan një lojë të baraspeshuar, me disa raste shënimi, por që rrjetat mbetet të patundura. Mundësinë më të mirë për Kosovën U 19 e pati Liridon Balaj në minutën e 64-t, por gjuajtja e tij nuk shkoi në rrjetë. Këto dy

miqësore me Bullgarinë i shërbyen përgjdhurit Krasniqi për t'u përgatitur sa më mirë për fazën "Elite Round" të kualifikimeve për Kampionatin Evropian, që do të zhvillohet prej 21 deri më 27 mars në Portugal ku, krahas Portugalisë, në grup do ta ketë dhe Republikën e Irlandës dhe Sllovinë.



## Vonn, një tjetër olimpiadë zhgënjyese, e treta në "Pyeongchang 2018"

**PYEONGCHANG, 22 SHKURT** - Olimpiada e "Pyeongchang 2018" ka qenë një zhgënjim për skiatoren amerikane Lindsey Vonn, që nga dy gara të zhvilluara në Lojërat Olimpikë, mori vetëm një medalje bronzi, në disiplinën

e zbritjes së lirë, garë e zhvilluar sot. "Prisja një fitore, por nuk e mora dot. Mendoj se dhashë më të mirën në pistë por, me sa duket, nuk isha mjaftueshëm e shpejtë", ka deklaruar Lindsey Vonn pas garës.

Olimpiada që zhvillohet në Korenë e Jugut me shumë gjasa do të jetë e fundit për skiatoren amerikane, tashmë 32 vjeçe. Edhe pse ishte favorite për ta fituar këtë garë, duke parë se është disiplina e saj e preferuar, Vonn zhgënjue

në pistë. "Nuk kam asnjë keqardhje, pasi dhashë maksimumin. Ndaj jam e kënaqur për medaljen e bronzit. Kisha emociione, pasi garova me idenë se kjo do të jetë gara ime e

fundit në një Olimpiadë", ka thënë Vonn.



## Përplasen Munishi dhe Rexha

Trajneri Ismet Munishi e ka quajtur "palaço" Kastriot Rexhën për shkak të stimulimeve në ndeshjen Drita - Feronikeli, kurse Rexha ka shprehur respekt për trajnerin Munishi dhe karrierën e pasur që ka pasur ai si futbollist



**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Trajneri i Feronikelit, Ismet Munishi, për "IndeksOnline" e ka quajtur sulmuesin e Dritës, Kastriot Rexhën, "palaço" për shkak të sjelljeve në ndeshjen Drita - Feronikeli (1-0). "E kam shikuar ndeshjen Drita - Feronikeli shumë herë. Lojtarët e mi kanë qenë të provokuar nga Kastriot Rexha gjatë gjithë kohës, i cili më shumë ka qëndruar në tokë se në këmbë. Më vjen shumë keq që Kastrioti luan rolin e 'palaços' sepse ka cilësi si futbollist dhe mund të japë shumë më tepër nëse koncentrohet në lojë e jo në aktrim. I sugjeroj gjyqtarët kundërshtarët që këtë fakt ta

ketë parasysh. Në asnjë moment nuk i arsyetoj lojtarët e mi, të cilët në këtë sfidë ranë pre e provokimeve. Nëse dikush dyshon në qëndrimin tim, le ta shikojë ndeshjen", ka thënë Munishi, i cili ka shtuar se Rexha është mburrur pas ndeshjes se e ka detyruar Behar Maliqin të ndëshkohet me të kuq. "I njëjti është mburrur pas ndeshjes se e ka detyruar Behar Maliqin të marrë karton të kuq. Kjo është e turpshme", ka shtuar Munishi. Ndërsa lidhur me akuzat e Munishit ka folur sulmuesi Kastriot Rexha, i cili ka thënë se ka respekt për trajnerin në fjalë. "Nuk kam çfarë të them për këto

fjalë. Unë kam respekt të madh për Ismet Munishin. Madje jemi me fat që e kemi në Superligë, sepse e bën edhe më interesante garën", ka thënë Rexha për "Insporti". "Ismeti ka luajtur në skuadra të mëdha, të cilat ne ndoshta as nuk e kemi pasur mundësi t'i shikojmë", ka shtuar Rexha, duke theksuar se është i përqendruar vetëm te loja e tij në radhët e Dritës. "Po punojmë me shumë përkushtim. Loja që treguam ndaj Feronikelit nuk ka qenë më e mira që mund ta bëjmë, por besoj se do të përmirësohemi vazhdimisht dhe t'i arrijmë objektivat e skuadrës", ka deklaruar Rexha.

## Vetteli: Magjia është në detaje

**ROMË, 22 SHKURT** - Ferrari ka hequr vetëm mbulesën dhe interesi i të gjithëve është se si do të lëvizë në pistë kokëkuqja. Me shumë interes në fakt pilotimin e saj e pret edhe Sebastian Vettel, që u shpreh shumë i emocionuar në prezantim. "Duket shumë e bukur dhe tani dëshirojmë të shkojmë në pistë ta provojmë: këtu janë shumë pak persona, por janë shumë të tjerë që kanë ndihmuar për ta realizuar këtë mrekulli dhe mezi presin që dëgjojnë nga ne pilotët se si do të jetë në pistë. Magjia në fakt vjen nga brenda: në çdo detaj, që është realizuar si një copëz puzzle. Është një makinë që shënon vërtet një hap përpara", u shpreh Vetteli. Dhe si çdo fillim sezoni, gjermani që kërkon ta rikthejë titullin te Ferrari shpreh shumë optimizëm: "Kemi gjithnjë pritshmëri pozitive dhe kemi bërë një punë shumë të madhe gjatë



dimrit. Është e vështirë të bësh vlerësime në këtë moment, por shpresoj shumë se pritshmëritë tona të konfirmohen në javët në vazhdim. Nuk kam asnjë mesazh për rivalët, duke qenë se ballafaqimi na pret në pistë". Shumë optimizëm ka shprehur edhe piloti tjetër i Ferrarit, kam-

pioni i fundit i botës me kokëkuqe, Kimi Raikkonen: "Është gjithnjë nder të jesh këtu. Ka shumë emocione dhe shumë punë të bërë. Pritshmëritë janë të tjera edhe me sistemin 'halo', edhe pse nuk ka ndryshim. Them se do të mësohemi", ka deklaruar piloti finlandez.

### SHKURT

#### Çerekfinalet e Kupës, më 6 dhe 7 mars

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) e ka caktuar orarin e ndeshjeve çerekfinale të Kupës së Kosovës, të cilat do të zhvillohen më 6 e 7 mars, duke filluar nga ora 13:00. Më 6 mars do të luhet vetëm ndeshja në mes të Dritës dhe Vëllaznimit, kurse derbi do të luhet të mërkurën më 7 mars në mes të Llapi dhe Prishtinës. Po të njëjtën ditë zhvillohet edhe takimi tjetër ndërmjet Gjilanit dhe Vushtrrisë.

#### Hudsoni përforcon KB Trepça

Basketbollisti amerikan Jonathan Hudson pritet të jetë i gatshëm për përballjet e Kupës së Kosovës me ekipin e tij të ri, Trepça. Ekipi mitrovicas ka paraqitur për regjistrim lojtarin që luan në pozitën e playmakerit. Hudsoni në këto ndeshje ka luajtur me 1 pikë si mesatare, 2 asistime dhe 0.5 topa të vjedhur. Njëjtë ai ka luajtur vetëm një ndeshje në elitën maqedonase, ku për 16 minuta sa ishte në fushë ka shënuar 3 pikë, 2 asistime dhe 1 kërcim. Hudsoni nuk qëndroi më shumë se një muaj te Blokotehna, ndërsa në stinorin e kaluar ka qenë tejet i vlerësuar në Palanga të elitës së Lituaniës.

#### Muntari transferohet në Spanjë

Skuadra e Deportivo La Corunas e ka zyrtarizuar transferimin e ish-mesfushorit të Milanit, Sulley Muntari. Futbollisti do të qëndrojë në Spanjë deri në fund të këtij sezoni. Ai ishte pa klub që prej largimit nga Pescara verën e shkuar. 33-vjeçari ribashkohet me Clarence Seedorf-in që është trajner i skuadrës në La Ligë.

#### Kondogbia: Dua të qëndroj te Valencia

Goefrey Kondogbia ia ka dhënë një 'shuplakë' Interit, gjatë një interviste për një media spanjolle, ku ka evidentuar dëshirën për të mos u kthyer më në Milano. Ai është shprehur se të zikaltrit mbizotëron kaosi, me trajnerë e lojtarë që ndërrohen çdo vit, ndaj edhe skuadra nuk arrin të shprehet. "Te Interi problemi i vërtetë është çekuilibrimi. Është pak ambient kaotik, pasi në dy vjetët e fundit kanë ndërruar 4-5 trajnerë dhe shumë lojtarë. Këto lloj situatash janë të vështira për t'u shprehur, aq më tepër kur je një lojtar i ri dhe ke nevojë për mbështetje dhe vazhdimësi", ka thënë Kondogbia, duke shtuar: "Një klub ka nevojë për vazhdimësi edhe kur gjërat nuk shkojnë mirë në fillim pasi, pavarësisht prej kualitetit, është e vështirë të shkosh përpara, nëse ndërrohet vazhdimisht. Unë jam shumë i lumtur te Valencia dhe po punoj shumë për ta merituar qëndrimin këtu, pasi dua të luaj gjatë për këtë skuadër".

#### Roberto vazhdon me Barçën

Ylli i Barcelonës, Sergio Roberto, e ka vazhduar kontratën me skuadrën nga "Camp Nou" deri në vitin 2022. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e Barcelonës. Roberto depërtoi në ekipin e parë të Barcelonës nga Barça B dhe ka plot 12 vjet në këtë klub, në të cilin ka theksuar se dëshiron të pensionohet. "Gjithmonë kam dashur të qëndroj këtu sepse jam këtu që nga fëmijëria ime. Po, klubet e tjera kanë shfaqur interesim, por jam i lumtur se do të vazhdojë të jem këtu deri më 2022. Shpresoj se nuk do të jetë rinovimi i fundit ky", ka thënë Roberto.

#### Totti: Salah, ndër më të mirët

Legjenda e Romës, Francesco Totti, thotë se ish-bashkëlojtari i tij, Mohamed Salah, është një prej më të mirëve në botë, por shprehur se ai ka potencial për t'u përmirësuar edhe më shumë. "Në nivelin të cilin ai është duke luajtur momentalisht, ai është një prej lojtarëve më të mirë në botë dhe mendoj se ai mund të përmirësohet edhe më shumë. E njoh atë mirë. Ai është një shok i mirë dhe dëshiron të përmirësohet, të bëhet edhe më i mirë si lojtar. Ai i bën të gjitha gjërat siç duhet, ai stërvitet shumë, ai i dëgjon trajnerët, kjo është arsyeja se pse po luan aq mirë momentalisht", ka thënë Totti.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Shëndetësisë  
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division*

### SHPALLJA E REKRUTIMIT

<b>I.</b>	
<b>Institucioni:</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Departamenti:</b>	Divizioni i Farmacisë
<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar i farmacisë (Në Depon Qendrore)
<b>Kategoria funksionale/Grada:</b>	Koeficienti 8
<b>Afati i kontratës:</b>	Me kohë të pa caktuar
<b>Nr. i Referencës:</b>	MSh-006/02/2018

#### Detyrat kryesore:

1. Farmacisti përgjegjës i Depos Qendrore mbikëqyrë procesin e pranimit/dorëzimit të mallit dhe siguron që ky proces të kryhet në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi;
2. Është përgjegjës për hyrje/daljet e faturave të pranimit dhe distribuimit në SMSF;
3. Përpilon procedurat standarde të veprimit për të siguruar përmbushjen e standardeve profesionale;
4. Komunikon me institucionet shëndetësore dhe organizon kohën e tërheqjes së mallit;
5. Përgatit raporte të rregullta periodike në lidhje me punën në Depo Qendrore;
6. Organizon dhe mbikëqyr regjistrimin periodik të stokut;
7. Mbikëqyr stafin e punësuar në Depon Qendrore;
8. Si dhe detyra tjera në bazë të kërkesave nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë;

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në Farmaci;

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Sc paku dy (2) vjet përvojë pune profesionale;
- Krijimi i marrëdhënieve të mira ndër-personale;
- Aftësitë e mira të komunikimit;
- Njohja e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Word dhe Excel)

#### II.

<b>Institucioni:</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Departamenti:</b>	Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Cilësisë dhe Sigurisë së Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar për Cilësi të Shërbimeve Shëndetësore
<b>Kategoria funksionale/Grada:</b>	Koeficienti 8
<b>Afati i kontratës:</b>	Me kohë të pa caktuar
<b>Nr. i Referencës:</b>	MSh-007/02/2018

#### Detyrat kryesore:

1. Sigurimi i strukturës së qëndrueshme organizative në rrafshin e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor;
2. Mbikëqyr cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore përmes kontrollit të zbatimit të rregullatës ligjore në të gjitha institucionet shëndetësore pavarësisht nga forma e pronësisë dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor të bazuar në dëshmi shkencore;
3. Koordinon procesin e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike, zhvillimit të dokumenteve të cilat sigurojnë praktikën e mirë mjekësore dhe indikatorëve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
4. Njëpërmjet vizitave në institucionet shëndetësore të çdo lloji të pronësisë, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor ushtron kontrollin organizativ lidhur me zbatimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
5. Mbikëqyr zbatimin e instrumenteve për matjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve dhe organizon trajnimin e profesionistëve për përdorimin e tyre;
6. Zhvillon sistemet individuale dhe organizative që kanë për qëllim themelor përmbushjen e indikatorëve të cilësisë;
7. Ofron këshilla teknike që kanë të bëjnë me sistemin e menaxhimit të cilësisë në sektorin e shëndetësisë edhe në projektet e donatorëve;
8. Merr pjesë në përgatitje të drafteve dhe udhëzimeve administrative dhe informatave qarkore në fushëveprimin e divizionit, merr pjesë në përgatitjen e planit të punës së divizionit dhe përgatitje raporte periodike dhe vjetore.

**Shkollimi i kërkuar:** Diploma e Fakultetit të Mjekësisë.

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Aplikantët me përvojë dhe trajnime në lëminë e cilësisë së shërbimeve shëndetësore kanë përparësi;
- Të njohë punën me kompjuter (WORD, EXEL, OUTLOOK);
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;

#### III.

<b>Institucioni:</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Departamenti:</b>	Inspektorati Farmaceutik
<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Inspektor Farmaceutik
<b>Kategoria funksionale/Grada:</b>	Koeficienti 8
<b>Afati i kontratës:</b>	Me kohë të caktuar (deri me 10.02.2019)
<b>Nr. i Referencës:</b>	MSh-008/02/2018

#### Detyrat kryesore:

1. Monitorimi, përkrahja e zbatimit të politikave, ligjeve, rregulloreve dhe standardeve;
2. Krijimi, mbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës për IF;
3. Këshillimi dhe konsultimi me Udhëheqësin për procedurat që duhet ndërmarrë për të gjitha çështjet e fushave të specializuara;
4. Garantimi i përputhshmërisë dhe këshillimi i prodhuesve dhe qarkulluesve farmaceutik me shumicë dhe pakicë, farmacistëve me kërkesat e rregulloreve, ligjeve, urdhërësive, udhëzimeve dhe direktivave në fuqi;
5. Të kryej të gjitha llojet e inspektimeve : gjenerale, rutinë, ad-hoc, speciale etj;
6. Të kontrollon dhe monitoron: prodhues të produkteve medicinale, substancave aktive, ekscipientet (tek prodhuesit vendore dhe të jashtëm), qarkullues me pakicë dhe shumicë, kontrollon dhe monitoron produktet dhe pajisjet medicinale në të gjitha institucionet shëndetësore të sektorit publik dhe privat, kontrollon produktin dhe pajisjen medicinale, kontrollon të gjitha specifikacionet të përshkruara në formularin e lejes së importit në pikat doganore;

7. Me qëllim të kontrollit të kualitetit të produkteve dhe pajisjeve medicinale kryen marrjen e mostrave dhe në bazë të analizave të vërtetuara në Laboratorin kombëtar merr masat adekuate të lejimit, ndalimit ose tërheqjen e produktit nga tregu.
8. Të ndërlidhet me Autoritetet Regjionale dhe Komunale të Shëndetësisë, Shërbimin Policor të Kosovës, Doganat e Kosovës, Agjencionet, si dhe me shërbimet tjera nëse ajo kërkohet nga udhëheqësi;
9. Të jetë i/e gatshme të asistojë në inspektime, mbledhje dhe takime të ndryshme sipas rekomandimit të Udhëheqësit
10. Merr përgjegjësinë e plotë dhe gatishmërinë për të gjitha detyrat e dhëna dhe të kërkuara nga Udhëheqësi.

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë universitare në farmaci, kimi, biologji, mjekësi, mjekësi veterinarë, kimi farmaceutike, teknologji farmaceutike, bazuar në Direktivën Evropiane 2001/83, neni 49 dhe Udhëzuesin Evropian mbi Inspektoratin nr.313525/2006 i preferueshem farmacist.

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Së paku 3 ( tri) vite përvojë pune profesionale;
- Të ketë patentë shofer, kategoria "B"
- I/e gatshëm të punojë në ekip, me orar fleksibil dhe në situata të tensionuara;
- Njohje e punës në kompjuter (MC Word dhe Excel) dhe të kërkimit në internet.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 23.02.2018 deri 09.03.2018**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren në recepcion ose në faqen zyrtare të ministrisë, dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 të Ministrisë së Shëndetësisë, Lagja Arbëria, rruga e Zagrebit p.n. (ish Spitali i mushkërive). Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 038 212 -276.

*"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."*

*Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".*

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Shëndetësisë  
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

*Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division*

## OGLAS ZA REGRUTOVANJE

**I.**  
**Institucija :** Ministarstvo zdravstva  
**Departman:** Divizija za farmaciju  
**Naziv radnog mesta:** Zvaničnik za farmaciju ( u Centralnom skladištu)  
**Funkcionalna kategorija-Gradiranje:** Koeficijent 8  
**Rok trajanja ugovora:** Na neodređeno vreme  
**Br.reference:** MZ-006/02/2018

### Glavni zadaci:

- Odgovorni farmaceut za Centralno skladište nadgleda proces prido-predeje robe i obezbeđuje da ovaj proces bude završen u skladu sa procedurama i pravilnicima na snazi;
- Odgovoran je za ulazne/izlazne prijeme i distribuirane fakture u SMSF;
- Sastavlja standardne procedure delovanja kako bi se osiguralo ispunjenje profesionalnih standarda;
- Komunicira sa zdravstvenim ustanovama i organizuje vreme povlačenja robe;
- Priprema redovne periodične izveštaje o radu u Centralnom skladištu;
- Organizuje i nadgleda periodični popis zaliha;
- Vrši nadzor osoblja zaposlenog u Centralnom skladištu;
- Obavlja i druge poslove na osnovu zahteva nadzornog rukovodioca.

**Zahtevano školovanje:** Univerzitetska diploma iz farmacije.

### Sposobnosti-iskustvo i ostali zahtevani atributi:

- Najmanje dve (2) godine radnog profesionalnog iskustva;
- Uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa;
- Odlučne komunikacijske veštine;
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru ( Microsoft Word i Excel).

**II.**  
**Institucija :** Ministarstvo zdravstva  
**Departman:** Departman za zdravstveni strateški razvoj  
**Divizija:** Divizija za kvalitet i bezbednost usluga zdravstvenih zaštite  
**Naziv radnog mesta:** Zvaničnik za kvalitet zdravstvenih usluga  
**Funkcionalna kategorija-Gradiranje:** Koeficijent 8  
**Rok trajanja ugovora:** Na neodređeno vreme  
**Br.reference:** MZ-007/02/2018

### Glavni zadaci:

- Obezbeđuje održivu organizacionu strukturu iz oblasti kontrole kvaliteta i bezbednosti zdravstvenih usluga nasvim nivoima zdravstvene zaštite;
- Nadgleda kvalitet i bezbednost zdravstvenih usluga kroz kontrolu sprovođenja zakonske regulative u svim zdravstvenim ustanovama, bez obzira na oblik vlasništva i bezbednost zdravstvene zaštite na osnovu naučnih dokaza;
- Koordinira proces izrade kliničkih smernica i protokola, izradu dokumenata koji obezbeđuju dobru medicinsku praksu i pokazatelje kvaliteta i sigurnosti zdravstvenih usluga;
- Putem poseta zdravstvenih ustanova svih vrsta imovine, na svim nivoima zdravstvene zaštite, vrši organizacionu kontrolu u vezi sa primenom standarda kvaliteta i sigurnosti zdravstvenih usluga;
- Nadgleda primenu instrumenata za merenje kvaliteta i bezbednosti usluga i organizuje obuku profesionalaca u vezi njihove upotrebe;
- Razvija individualne i organizacione sisteme koji imaju za osnovni cilj ispunjavanje indikatora kvaliteta;
- Pružia tehničke savete koji se odnose na sistem upravljanja kvalitetom u zdravstvenom sektoru i u donatorskim projektima;
- Učestvuje u izradi nacarta i administrativnih uputstava i kružnih informacija u okviru delovanja divizije, učestvuje u pripremi plana rada divizije i sastavlja periodične i godišnje izveštaje.

**Zahtevano školovanje:** Diploma Medicinskog fakulteta.

### Sposobnosti-iskustvo i ostali zahtevani atributi:

- Najmanje dve (2) godine radnog profesionalnog iskustva;
- Prednost imaju aplikanti koji imaju iskustvo i obuku iz oblasti kvaliteta zdravstvenih usluga;
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru ( Word , Excel, Outlook).
- Poznavanje engleskog jezika predstavlja prednost;

**III.**  
**Institucija :** Ministarstvo zdravstva  
**Departman:** Farmaceutski inspektorat  
**Naziv radnog mesta:** Farmaceutski inspektor  
**Funkcionalna kategorija-Gradiranje:** Koeficijent 8  
**Rok trajanja ugovora:** Na određeno vreme ( do 10.02.2019)  
**Br.reference:** MZ-008/02/2018

### Glavni zadaci:

- Praćenje, podržavanje sprovođenja politika, zakona, pravilnika i standarda;
- Stvaranje, održavanje i razvoj infrastrukture za FI ;
- Savetovanje i konsultacije sa rukovodiocem o procedurama koje će biti preduzete po svim pitanjima specijalizovanih oblasti;
- Garantovanje usaglašenosti i savetovanje proizvođača i farmaceutskih prometnika na malo, farmaceuta u vezi sa zahtevima o pravilnicima, zakonima naredbama, uputstvima i direktivama na snazi;
- Obavlja sve vrste inspekcija: opštu, rutinsku, ad-hoc, specijalnu i dr;
- Kontroliše i vrši monitoring: proizvođača medicinskih proizvoda, aktivnih supstanci, ekscipijenata (domaćih i stranih proizvođača), prometnika na malo i veliko, kontroliše i monitoriše medicinske proizvode i opremu u svim zdravstvenim ustanovama javnog i privatnog sektora, kontroliše proizvode i medicinsku opremu, kontroliše sve specifikacije opisane u formularu uvozne dozvole na carini;

- U cilju kontrole kvaliteta medicinskih proizvoda i opreme obavlja uzimanje uzoraka na osnovu analiza utvrđenih u Nacionalnoj laboratoriji i preduzima adekvatne mere za dozvolu, zabranu ili povlačenje proizvoda sa tržišta;
- Uspostavlja saradnju sa regionalnim i opštinskim zdravstvenim autoritetima Kosovskom policijskom službom, Kosovskom carinom, agencijama kao i ostalim službama po zahtevu rukovodioca;
- Spreman/a da pomaže u inspekciji, prisustvuje na raznim sastancima prema preporukama rukovodioca;
- Preuzima punu odgovornost za sve postavljene dužnosti koje se zahtevaju od strane rukovodioca.

**Zahtevano školovanje:** Univerzitetska diploma iz oblasti farmacije , hemije, biologije, veterinarska medicina, farmaceutske hemije, farmaceutske tehnologije, na osnovu Evropske direktive 2001-83, člana 49 i Evropskog vodiča o inspektoratu br. 313525-2006 poželjna farmacija.

### Sposobnosti/iskustvo i zahtevani atributi:

- Najmanje tri (3) godine radnog profesionalnog iskustva ;
- Da ima vozačku dozvolu " B" kategorije;
- Spreman za timski rad, da radi sa fleksibilnim rasporedom i u situacijama pod pritiskom.
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru ( MC Word i Excel) i internetskog potraživanja.

**Uslovi za učešće u regrutovanju:** Pravo aplikacije imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koji su završili adekvatno školovanje i koji imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova.

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje :** Na osnovu Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi na Kosovu kao i Uredbe br.02/2010 o proceduri regrutovanja u javnoj službi.

**Vremenski rok imenovanja:** Karijerni službenik, na neodređeno vreme .

**Datum publikacije i zatvaranja konkursa:** 23.02.2018 do 09.03.2018

**Prijave aplikacija:** Aplikacije se mogu dobiti na recepciji ili preuzeti sa web stranice ministarstva i dostaviti u kancelariju br. 23 Ministarstva zdravstva na adresi: ulica "Zagrobačka" b.b.( bivša plućna bolnica). Na aplikaciji jasno navedite naziv radnog mesta i broj reference. Kontaktirati na telefon. : 038 212 -276.

**"Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova, i prima aplikacije od osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.**

**Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na proporcionalnu zastupljenost u civilnoj službi javne administracije, centralne i lokalne, kako je predviđeno u članu 11, stav 3 Zakona br.03-L-149 o civilnoj službi Republike Kosova".**

*Nekompletirane prijave i prijave nakon isteka roka neće se uzimati u obzir.  
Zhog prevelikog broja primljenih prijava ,kontaktiraće se samo oni kandidati koji su izabrani u užem krugu.*

**C.nr. 7/2018**

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË,** Gjyqtari Nuredin Abazi, me Asistenten Hyrzeme Shurdhaj, në lëndën civile sipas padisë se paditesit Tauland Mursel Arifaj nga fshati Peqan, K. e Suharekes, me qendrim te perkoreshem ne Treviso te Italise, te cilin me autorizim bartes e perfaqeson Av. Gentian Krasniqi nga Suhareka, kunder te paditures Liridona Hisni Kokollaringa fshati Budakove, me adrese te panjohur, me padi per zgjidhjen e martesese, me dt. **20.02.2018.** bie kete:

### AKTVENDIM

Te paditures Liridona Hisni Kokollari nga fshati Budakove, Komuna e Suharekes, aktualisht me vendbanim te panjohur, i caktohet perfaqesuesi i perkoreshem Av. Ruzhdi Gashi nga Suhareka.

Ne kuptim te nenit 82 te Ligjit te Procedures Kontestimore (LPK), perfaqesuesi i perkoreshem i ka te gjitha te drejtat dhe detyrat e perfaqesuesit ligjor, te cilat i ushtron deri sa te paraqitet ne Gjykate i padituri apo perfaqesuesi i tij me prokurere, gjegjesisht deri sa organi i kujdestarse ta njoftoj Gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky Aktvendim do te shpallet ne gazeten zyrtare dhe ne nje nga gazetate e perditeshme ditore, si dhe ne tabelen e shpalljeve te Gjykates.

Arsyetim

Paditesi permes te autorizuarit te tij prane kesaje Gjykate ka parashtuar padi per zgjidhjen e martesese ndaj te paditures.

E paditura nuk ka mundur te fothet nga gjykata pasi qe ne padi ceket se e njejta ka vendbanim te panjohur.

Paditesi gjegjesisht i autorizuarit i tij ne seancen e dt. 20.02.2018. i propozon Gjykatës që te paditures ti caktohet përfaqësuesi i përkoreshëm nga radha e listes se Avokateve te licencuar i cili do ta përfaqësoi të paditoren në seancat gjyqësore pasi që nuk ka qen e mundur te gjindet adresat e sajë.

Meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përfaqësuesit të përkoreshëm sipas propozimit të autorizuarit të padures, gjykata në kuptim të nenit 79.3 nën (a), 81,82 dhe 83 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këti Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN-DEGA NE SUHAREKË NË SUHAREKË,**  
**C.nr. 7/2018 dt. 20.02.2018.**

Asistentja,  
H. Shurdhaj

**GJYQTARI,**  
**Nuredin/Abazi**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këti aktvendimi pala e pa knaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njejtij Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.



Drejtoria e Gjimnazit "Gjon Buzuku" në Prizren  
Nr. prot: 386 Data: 22.02.2018  
Prizren

Mbështetur në UA 02/2016 të dt. 12.01.2016, nenin 11, dhe në vendimin nr. Prot: 294 të datës 15.02.2017, të KDSH, - Gjimnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, shpall:

### Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të gjimnazit "Gjon Buzuku" Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatore te udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjimnazit "Gjon Buzuku" Prizren, për në Republikën e Shqipërisë më datë 07.05.2018 deri më 12.05.2018.

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë kushtet të paraqitura në aplikacion:

Ofertuesit e interesuar aplikacionet me itinerarin e udhëtimeve dhe kriteret e perzgjedhjes mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në DKA Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë punë, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2017, më 05.03. 2018 në ora 16.00 në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes, Komisioni i parapar sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e përshtatshmërisë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Kriteri i përzgjedhjes së Agjencionit Turistik do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike. Poentimit do ti nënshtrohen vetëm AT të cilët do të përmbushin kushtet e përshtatshmërisë. Drejtoria shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Vërejtje: Kompanitë turistike të pa kënaqura kanë të drejtë ankese brenda 3 ditëve që nga dita e shpalljes së fituesit tek komisioni selektues në shkollën që e ka shpallur ftesën për ofertë.



KOMUNA E PRIZRENIT  
Drejtoria për Shëndetësi



Qendra Kryesore e  
Mjekësisë Familjare

Komuna e Prizrenit  
Drejtoria për Shëndetësi  
QKMF -Prizren  
Nr.20/6  
Datë: 23.02.2018  
P R I Z R E N

Njësia e Burimeve Njerëzore lëshon këtë:

Datë:23.02.2018

### NJOFTIM Për anulimin e konkursit

Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren, anulon Konkursin me Nr. 12/18 për vendet e punës: Doktor i Mjekësisë së Përgjithshme 4(katër), Vozitës 2(dy), Shtëpiak 2(dy) dhe Punëtor hixhienik 1(një ), të publikuar në gazetën ditore "Epoka e Re" me datën 02.12.2017.

Jedinita za Ljudske resurse izdaje ovo:

Datum:23.02.2018

### OBAVEŠTENJE O poništenju konkursa

Direkcija za Zdravstvo Opštine u Prizrenu sa Glavnim Centrom Porodične Medicine u Prizrenu, poništava konkurs sa br.12/18 za radna mesta: Doktor opšte Medicine 4(četiri), Vozač 2(dva), Domar 2(dy) i Higijenski radnik 1(jedan), objavljenog u dnevnom novinama "Epoka e Re" dana 02.12.2017.

Insan Kaynakları Birimi aşağıda yer alan bildiriyi ilan eder:

Tarih: 23.02.2018

### Konkurun iptal edildiğine dair BİLDİRİ

Prizren Belediyesi Sağlık Müdürlüğü ve Prizren Aile Hekimliği Ana Merkezi 02.12.2017 tarihinde " Epoka e Re" günlük gazetede yayımlanan 12/18 sayılı şu işyerleri için açılan konkuru iptal etmiştir: Genel Tıp Hekimi 4 (dört), Şoför 2 (iki), Ev çalışanı 2 (iki) ve hijyen çalışanı 1 (bir).

Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS  
A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa Champion



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec

Njësia e Personelit / Jedinica za Osoblje / Personnel Unit

Në bazë të nenit 8 dhe paragrafit 2.3 të nenit 10 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.577/2018, Njësia e Personelit e komunës së Rahovecit shpall:  
Na osnovu člana 8 ,stav. 2.3, člana 10.Zakona o Radu Br.03/L-212, Odluke Predsednika Opštine 01Br.577/2018.g. Jedinica za Osoblje opštine Orahovac objavljuje:

**K O N K U R S**

**Titulli i vendit të punës:** Anketues i pronave të paluajtshme-objekteve.  
**Naziv radnog mesta:** Vršioč ankete nepokretne imovine – objekata.

**Njësia Organizative:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
**Organizaciona jedinica:** Odeljenje za Budžet i Finansije

**Numri i referencës:** DBF-1/2018  
**Referentni broj:** OBF-1/2018

**Niveli i pagës:** 300.00 € bruto  
**Nivo plate:** 300.00 €, bruto

**Raporton te:** Sektori për tatimin në pronë  
**Izveštava:** Sektor porca na imovinu

**Lloji i kontratës:** Kontratë për punë dhe detyra specifikë  
**Vrsta ugovora:** Ugovor o radu i specifičnom zadaci

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 muaj  
**Vreme trajanja ugovora:** 4 meseca

**Orari i punës:** Orar të plotë  
**Radno Vreme:** Puno radno vreme

**Numri i ekzekutuesve:** 4 ( katër)  
**Broj izvršioča:** 4 ( četiri)

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Viziton objektet e caktuara dhe regjistrin pronarin, shfrytëzuesin
- Klasifikon pronën si dhe përshkruan të dhënat në formularin e aprovuar për shënimet e nevojshme
- Zbaton udhëzimet e MF- DTP për verifikimet dhe regjistrimet e pronave
- Bashkëpunon ngushtë me zyrën kadastrale Komunale me qëllim të sigurimit të materialit të nevojshëm për regjistrimin apo verifikimin e objekteve si dhe informon shpërndarësit për azhurnimet (freskimet) e dosjeve të tatimpaguesve që duhet bërë dhe që kanë të bëjnë me referencat kadastrale
- Bashkëpunon me të gjithë punëtorët e tjerë të zyrës së tatimit në pronë për të gjitha çështjet në interes të kësaj zyre
- Organizon punë të caktuara dhe mban kopje në dosje të radhitura mirë në bazë të procedurave të themeluara nga Menaxheri-Drejtori i tatimit në pronë
- Kryen aktivitetet tjera të zyrës së tatimit mbi pronë të caktuara nga eprori

**Zadaci i odgovornosti:**

- Poseçiva određene objekte i registruje vlasnika, korisnika
- Klasifikuje imovinu kao i opisuje podatke u odobrenom obrascu za potrebne podatke-
- Sprovodi upute M.F-O.P.I za verifikaciju i upis imovine
- Blisko saraduje sa Opštinskom katastarskom kancelarijom u cilju obezbeđivanja potrebnog materijala za upis i verifikaciju objekta kao i obaveštava dostavljajuća za prerađu (osvežavanje) dosija poreznika koji se tiče i koje treba izvršiti na osnovu katastarskih referenca-
- Saraduje sa ostalim radnicima kancelarije poreza na imovinu o svim pitanjima u interesu ove kancelarije
- Organizuje određene poslove i nosi kopiju u dobro uređeni dosije na osnovu postupaka osnivani od Menadžera – Direktora poreza na imovinu
- Vršiti ostale aktivnosti kancelarije poreza na imovinu određenih od starešine

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Uslovi učesća na konkursu:**

Pravo aplikacije na ovom konkursu imaju svi punoletni državljani Republike Kosovo, koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebno obrazovanje i stručnu sposobnost za izvršenje radova i koji imaju fizičku sposobnost za dotični položaj.

**Kriteret minimale që duhet të plotësojnë kandidatët :**

- Të ketë të përfunduar fakultetin ose kolegjin
- Të ketë aftësi kompjuterike të paketës së Microsoft -it: Excel, Word.

**Minimalni kriterijumi koji trebaju da ispune kandidati:**

- Da ima završen fakultet ili koledž
- Da ima kompjutersku sposobnost paketa Microsoft: Excel, Word

**Dokumentet:**

- Diploma
- Certifikata që nuk është nën hetime
- Certifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- CV-ja

**Dokumentacija:**

- Diploma
- Potvrda da nije pod istragom
- Izvod Rodenja
- Kopija lične karte
- CV

**Data e mbylljes së konkursit:**

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

**Dan zatvaranja konkursa:**

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objave.

**Paraqitja e kërkesave:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Komunën e Rahovecit- Zyrën e pranimit në katin për dhës. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të nevojshme, siç kërkohet te pjesa e konkursit te **dokumentet**.

**Dostava zahteva:**

Aplikacije se mogu uzeti i dostaviti u Opštini Orahovac – u kancelariji za prijem, u prizemlju. Aplikaciji treba priložiti kopije potrebnih dokumenta, kao što se zahteva u delu konkursa. **Dokumentacija.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen, kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Dostavljeni zahtevi nakon završetka vremenskog roka neće se uzeti u obzir, zahtevi koji nisu upotpunjeni će se odbiti.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

U slučaju prijema velikog broja zahteva, samo izabrani kandidati u uzoj listi će se kontaktirati

01Nr.Br.587  
Me dt/dana 20.02.2018  
Rahovec/Orahovac



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premiera/Office of Prime Minister

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Kancelarija za pitanja zajednica/Office for Community Affairs

**Njoftim**

I njoftojmë të gjithë të interesuarit për aplikim në pozitën mësimdhënëse në gjuhës shqipe dhe serbe, në Zyrën për Çështje të Komuniteteve/Zyra e Kryeministrit, se vazhdohet afati i Konkursi Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Të interesuarit mund të aplikojnë deri me datën 28.02.2018.

**Obaveštenje**

Obaveštavamo sve kandidate, koji su zainteresovani za poziciju nastavnika albanskog i srpskog jezika, u Kancelariji za pitanja zajednica/ Kancelarija premijera, da će se raspisani javni konkurs za sporazum o posebnom uslugama produžiti. Podnosioci zahteva mogu se prijaviti do 28.02.2018.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Valbona Gashi- Krasniqi, nga shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit juridik të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë.

► Nazmi Isufi Shpall të pavlefshëm dëftesat prej klasës së I deri VIII, Shkolla Filllore "Ilaz Thaçi" Hani Elezit.

► Qamil Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I -VIII shf " Anadollu" Mamush

► Shkurte Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Anadollu" Mamush

► Ilirida Recaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Matilo Goreci" Prizren

► Rine Lamaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Avdyl Frasher" Prizren

► Miftar Aliu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ekrem Rexha Drini " Lubizhd

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

*Gjithmon me merr malli për vonën tëm  
Urimë dita e pavarësisë!*

**RC**  
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë  
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme  
familjet e mi kanë me qere krenar  
me kësi ba në sot.*


*Ndoshta ka shumë punë që me arrit a  
ka duhet por e di që këtu ka njëz që  
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

**10 mesazhe  
Kosovës**

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qere anderr për n  
Qe prej asaj dite une besoj që puna m  
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!  
Zemra pushon, vete këtu!*

**MADE IN  
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën  
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm  
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*



**Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.**